b) në rastin e shërbimeve: natyrën dhe shtrirjen e shërbimit, pavarësisht nëse shërbimi përfshin ose jo eksperienca specifike, njohuri teknike ose përdorim të aktiveve jomateriale etj.;

c) në rastin e transaksioneve të financimit: vlerën e principalit, periudhën, garancitë, monedhën, aftësinë paguese të debitorit, sigurimin, normën e interesit etj.;

d) në rastin e aktiveve jomateriale: formën e transaksionit (p.sh. licencim ose shitje), tipin e pronës (p.sh. patentë, markë tregtare ose njohuri), kohëzgjatjen dhe shkallën e mbrojtjes, përfitimet e pritshme nga përdorimi i pasurisë etj.;

e) në rastin e tjetërsimit të aksioneve ose investimeve të tjera: llogaria e përditësuar e kapitalit të emetuesit, vlera aktuale e përfitimeve ose lëvizjeve të parashikuara të parasë, kuotimi i tregut për stokun e aksioneve në momentin e transfertës etj.

5.3 Në analizën e funksioneve të ndërmarra, aktiveve të përdorura dhe risqeve të parashikuara, elementët përkatës mund të përfshijnë, por pa u kufizuar në:

a) funksionet, si: projektimi, prodhimi, montimi, kërkimi dhe zhvillimi, shërbimi, blerja, shpërndarja, marketingu, reklamimi, transportimi, financimi, menaxhimi etj.;

b) aktivet, si: makineri dhe pajisje, përdorimi i aktiveve jomateriale të vlerësuara, aktiveve financiare etj., dhe marrjen në konsideratë të natyrës së aktiveve të përdorura, si: vjetërsia, vlera e tregut, vendndodhja, mbrojtje të disponueshme të së drejtës së pronësisë etj.;

c) risqe, si: risqet e tregut, risqet e humbjes të lidhura me investimin dhe përdorimin e pronës, makinerive dhe pajisjeve, risqet e suksesit ose dështimit të investimit në kërkim dhe zhvillim, risqet financiare si ato të shkaktuara nga kurset e këmbimit të monedhave dhe ndryshueshmëria e normave të interesit, risqet e kreditit etj.

5.4 Në analizën e kushteve kontraktuale, përveç parashikimeve të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi interpretimin e kontratave, nenet 681–689, duhet të ndërmerret një ekzaminim për të përcaktuar nëse sjellja e palëve përputhet me kushtet e kontratës, ose nëse sjellja e palëve tregon që nuk janë zbatuar kushtet kontraktuale, ose nëse gjendemi para një rasti mashtrimi. Në rastin e fundit, kërkohen analiza të mëtejshme për të përcaktuar kushtet e vërteta të transaksionit. Kur nuk ka asnjë kontratë të shkruar, kushtet e transaksionit mund të evidentohen/konkludohen nga korrespondenca/komunikime të tjera ndërmjet palëve, sjellja e tyre dhe/ose parimet ekonomike që përgjithësisht udhëheqin marrëdhëniet midis shoqërive të pavarura.

5.5 Në analizën e kushteve ekonomike, elementët përkatës mund të përfshijnë, por pa u kufizuar në: vendndodhjen gjeografike; madhësinë e tregut; shtrirjen e konkurrencës në tregje dhe pozitat përkatëse konkurruese të blerësve dhe shitësve; disponueshmërinë (pra, riskun) e mallrave dhe shërbimeve zëvendësuese; nivelet e ofertës dhe kërkesës së tregut në përgjithësi dhe në rajone të veçanta, fuqinë blerëse të konsumatorit, natyrën dhe shtrirjen e rregullimeve të qeverisë në treg, kostot e prodhimit (duke përfshirë kostot e tokës, punës dhe kapitalit) kostot e transportit; nivelin e tregut (p.sh. me pakicë apo me shumicë); dhe datën dhe kohën e transaksioneve.

5.6 Në analizën e strategjive të biznesit, elementët përkatës mund të përfshijnë, por pa u kufizuar në strategjitë e lidhura me depërtimin e tregut, diversifikimin, inovacionin, zhvillimin e produktit, shmangien e riskut, ndryshimet politike etj.

5.7 Procesi i mëposhtëm, duhet të merret në konsideratë në vlerësimin e krahasueshmërisë. Gjithsesi ndjekja e këtij procesi nuk është e detyrueshme - me rëndësi është rezultati dhe jo procesi.

1. Përcaktimi i viteve që do të mbulohen;

2. Analiza me bazë të gjerë e rrethanave të tatimpaguesit;

3. Kuptimi i transaksionit(eve) të kontrolluar(a) nën ekzaminim, bazuar veçanërisht në një analizë funksionale, në mënyrë që të ndihmojë për zgjedhjen e palës së testuar në përputhje me këtë udhëzim (kur është e nevojshme); zgjedhja e metodës më të përshtatshme të transferimit të çmimit me rrethanat e rastit në përputhje me këtë udhëzim; zgjedhja e treguesit financiar që do të testohet (kur është e nevojshme); dhe të identifikohen faktorët e rëndësishëm të krahasueshmërisë që duhet të merren në konsideratë;

4. Rishikimi i transaksioneve ekzistuese të brendshme të krahasueshme të pakontrolluara, nëse ka;

5. Përcaktimi i burimeve të disponueshme të informacionit mbi transaksionet e jashtme të krahasueshme, kur këto transaksione të jashtme të krahasueshme janë të nevojshme, duke marrë në konsideratë besueshmërinë e tyre relative;

6. Zgjedhja e metodës më të përshtatshme të transferimit të çmimit në përputhje me këtë udhëzim dhe, në varësi të metodës, përcaktimi i treguesve financiarë përkatës;

7. Identifikimi i transaksioneve potenciale të krahasueshme: përcaktimi i karakteristikave kryesore që duhet të plotësohen nga çdo transaksion i pakontrolluar në mënyrë që të konsiderohet si potencialisht i krahasueshëm, bazuar në faktorët përkatës të identifikuar në hapin 3 dhe në përputhje me faktorët e krahasueshmërisë të specifikuar në nenin 33, paragrafi 2 të ligjit;

8. Përcaktimi dhe kryerja e veprimeve rregulluese të krahasueshmërisë kur është e nevojshme, duke marrë në konsideratë pikën 6 më poshtë;

9. Interpretimi dhe përdorimi i të dhënave të mbledhura, përcaktimi i kushteve në përputhje me parimet e tregut.

6. Veprimet rregulluese të krahasueshmërisë

6.1 Për qëllime të nenit 33, paragrafi 1, shkronja "b" të ligjit, veprimet rregulluese të krahasueshmërisë duhet të merren në konsideratë vetëm nëse pritet që ato të rrisin besueshmërinë e rezultateve, duke marrë parasysh konsiderata, të tilla si:

a) materialiteti i diferencës për të cilën rregullimi është marrë në konsideratë;

b) cilësia e të dhënave që janë subjekt i rregullimit;

c) qëllimi i rregullimit; dhe

d) besueshmëria e metodës së përdorur për kryerjen e rregullimit.

6.2 Veprimet rregulluese të krahasueshmërisë mund të përfshijnë, por pa u kufizuar në to, rregullime për:

a) sigurimin e qëndrueshmërisë kontabël, p.sh. rregullime të përcaktuara për të eliminuar diferencat që mund të vijnë nga ndryshimi i praktikave kontabël të përdorura në lidhje me transaksionet e kontrolluara dhe transaksionet e pakontrolluara;

b) diferenca në kapital, funksione, aktive, risqe;

c) diferenca në kushtet aktuale; ose

d) diferenca midis tregjeve gjeografike.

Shembull*. Gjatë vitit 2014, shoqëria X i shiti 8 milionë, njësi të produktit G shoqërisë Y, palë e lidhur dhe 1 milion njësi të të njëjtit produkt një pale të pavarur, shoqërisë A. E vetmja diferencë e rëndësishme ndërmjet transaksioneve, duke marrë në konsideratë pesë faktorët e krahasueshmërisë, të specifikuar në nenin 33, paragrafi 1, shkronja "b", është se shoqërisë Y i ofrohet një zbritje në sasi prej 5%. Shoqëria A nuk bleu një sasi të mjaftueshme të njësive të produktit për të përfituar nga zbritja në sasi. Zbritja në sasi e ofruar shoqërisë Y është në përputhje me praktikat e industrisë dhe kushtet kontraktuale zbulojnë se e njëjta zbritje duhej të ishte vendosur në dispozicion të shoqërisë A nëse do të ishte blerë një sasi e njëjtë me atë të blerë nga shoqëria X. Në një rast të tillë, një veprim rregullues i krahasueshmërisë duhet të kryhet për të eliminuar efektet e kësaj diference.*

7. Burimet e informacionit të krahasueshëm

7.1 Transaksionet e krahasueshme të pakontrolluara mund të jenë:

a) Transaksionet e brendshme të krahasueshme të pakontrolluara, të cilat janë transaksione të krahasueshme të pakontrolluara, ku njëra nga palët e transaksionit të kontrolluar është gjithashtu palë në transaksionin e krahasueshëm të pakontrolluar;

b) Transaksionet e jashtme të krahasueshme të pakontrolluara, të cilat janë transaksione të krahasueshme të pakontrolluara, ku asnjëra nga palët e transaksionit të kontrolluar nuk është palë në transaksionin e krahasueshëm të pakontrolluar.

7.2 Një transaksion i pakontrolluar mund të përdoret nga autoritetet tatimore për qëllimet e kryerjes së një veprimi rregullues sipas nenit 32, paragrafi 1 të ligjit, vetëm nëse elementet përkatëse të transaksionit nuk përmbajnë një sekret tatimor dhe ka burime të tjera informacioni për këtë transaksion.

7.3 Në mungesë të transaksioneve të brendshme të krahasueshme të pakontrolluara, autoritetet

tatimore do të pranojnë përdorimin e transaksioneve të huaja të krahasueshme të pakontrolluara me kusht që të analizohet ndikimi i diferencave gjeografike dhe faktorëve të tjerë mbi treguesin financiar që po ekzaminohet sipas metodës së përshtatshme, të transferimit të çmimit, dhe, kur është e përshtatshme, të kryhen veprime rregulluese të krahasueshmërisë.

7.4 Në mungesë të transaksioneve të jashtme të krahasueshme të pakontrolluara, që i përkasin të njëjtit vit fiskal si transaksioni(et) i(e) kontrolluar(a), të disponueshme në momentin e përgatitjes së dokumentacionit të transferimit të çmimit të specifikuar në nenin 37 të ligjit, tatimpaguesi mund të mbështetet në informacionin që lidhet me transaksionet e jashtme të krahasueshme të pakontrolluara, nga periudha më e fundit, për të cilën ky informacion është i vlefshëm, me kusht që standardi i krahasueshmërisë në nenin 33 të ligjit të jetë përmbushur.

8. Metodat e transferimit të çmimit

Metoda e çmimit të krahasueshëm të pakontrolluar

8.1 Çmimi është treguesi financiar i duhur për zbatimin e metodës së çmimit të krahasueshëm të pakontrolluar siç përcaktohet në nenin 34, paragrafi 1, shkronja "a" të ligjit. Ky çmim mund të jetë një shumë e specifikuar në një monedhe të dhënë, ose një përcaktim direkt i tillë si një normë interesi ose tarifë e së drejtës së autorit. Krahasimi i çmimit në transaksionin e kontrolluar mund të bëhet me çmimin e transaksionit të krahasueshëm të pakontrolluar të brendshëm ose me çmimin e transaksionit të krahasueshëm të pakontrolluar të jashtëm, në varësi të disponueshmërisë së informacionit dhe/ose ekzistencës së këtyre transaksioneve.

Shembull*. Supozojmë se shoqëria X prodhon produktin ujë me shishe nga i cili i shet një pale të pavarur (shoqërisë A) dhe një pale të lidhur (shoqërisë Y) dhe shitjet për të dyja palët janë ujë me shishe të njëjtit tip, cilësi dhe markë; përfshijnë sasi të ngjashme; kryhen pothuajse në të njëjtën kohë, në të njëjtën fazë të zinxhirit të prodhimit/shpërndarjes dhe në kushte të ngjashme, dhe, janë në treqe të krahasueshme. Nëse midis transaksioneve nuk ka diferenca që ndikojnë në mënyrë materiale çmimin, ose, kur këto diferenca ekzistojnë, efekti mund të eliminohet nëpërmjet rregullimeve të arsyeshme dhe të sakta të krahasueshmërisë, atëherë qëndrueshmëria e kushteve në transaksionet e kontrolluara mund të përcaktohet nëpërmjet krahasimit direkt të çmimit të vendosur me çmimin e vendosur në transaksionin me palën e pavarur.*

Metoda e çmimit të rishitjes

8.2 Treguesi financiar përkatës për zbatimin e metodës së çmimit të rishitjes, siç përcaktohet në nenin 34, paragrafi 1, shkronja "b" të ligjit, është marzhi i çmimit të rishitjes. Ky marzh është fitimi bruto (pra fitimi përpara zbritjeve të shpenzimeve operative dhe të tjera të shitjeve), si një përqindje e të ardhurave nga shitja e mallrave. Krahasimi i marzhit të çmimit të rishitjes mund të kryhet me marzhin(et) e çmimit të rishitjes të transaksionit të krahasueshëm të pakontrolluar të brendshëm ose të transaksionit të krahasueshëm të pakontrolluar të jashtëm, në varësi të disponueshmërisë së informacionit dhe/ose ekzistencës së transaksioneve të tilla.

Shembull*. Shoqëria X, rezidente e shtetit X, prodhon produkte elektronike duke përdorur teknologjinë që ajo ka zhvilluar dhe i shet këto produkte tek një palë e lidhur me të, shoqëria Y, e cila është rezidente e shtetit Y. Shoqëria Y e shpërndan produktin në tregun e shtetit Y tek palë të pavarura dhe nuk ndërmerr ndonjë funksion të rëndësishëm për shtimin e vlerës. Një kërkim për shpërndarësit e krahasueshëm të pavarur, të cilët operojnë në shtetin Y, identifikoi 7 shpërndarës të pavarur me marzhe të çmimit të rishitjes që varionin nga 39% në 46%. Një analizë krahasueshmërie zbulon se nuk ka diferenca të rëndësishme të cilat do të ndikonin në mënyrë materiale marzhin e çmimit të rishitjes. Për rrjedhojë, duke supozuar se metoda e çmimit të rishitjes është metoda më e përshtatshme, nëse shoqëria Y fiton një marzh të çmimit të rishitjes nga 39% në 46%, mund të konkludohet se kushtet e transaksionit(ve) të kontrolluar (p.sh. shitja e produkteve nga shoqëria X tek shoqëria Y) janë në përputhje me parimin e tregut.*

Metoda "kosto plus"

8.3 Treguesi financiar përkatës për aplikimin e metodës "kosto plus", siç përcaktohet në nenin 34, paragrafi 1, shkronja "c" të ligjit, është kosto plus marzhin e kërkuar. Marzhi i kërkuar i "kostos plus" përcaktohet si marzhi mbi kostot direkte dhe indirekte, por jo kostot operative. Kur aplikohet metoda kosto plus është shumë e rëndësishme të aplikohet një marzh i kërkuar i kostos plus i krahasueshëm me një bazë kosto të krahasueshme (p.sh. duke përfshirë të njëjtat tipa të kostove direkte dhe indirekte). Krahasimi i marzhit të kërkuar të kostos plus mund të bëhet me marzhin e kërkuar të kostos plus në transaksionet e krahasueshme të pakontrolluara të brendshme ose në transaksionet e

krahasueshme të pakontrolluara të jashtme, në varësi të disponueshmërisë së informacionit dhe/ose ekzistencës së transaksioneve të tilla.

Shembull*. Shoqëria X, rezidente në shtetin X, prodhon rroba bazuar në specifikimet e dhëna nga një palë e lidhur me të, shoqëria Y, e cila është rezidente në shtetin Y. Dizenjot e përdorura nga shoqëria X jepen nga shoqëria Y me kushtin që shoqëria Y mund t'i përdorë këto dizenjo vetëm për të prodhuar një numër të caktuar njësish të cilat më pas blihen nga shoqëria Y me kushtin e plotësimit të standardit të cilësisë. Një kërkim për prodhuesit e krahasueshëm të pavarur që operojnë në shtetin X identifikoi 5 prodhues të pavarur me marzhe kosto plus që variojnë nga 20% në 25%. Një analizë krahasueshmërie tregon se nuk ka diferenca të rëndësishme të cilat do të ndikonin në mënyrë materiale marzhin. Për rrjedhojë, duke supozuar se metoda "kosto plus" është metoda më e përshtatshme, nëse shoqëria X aplikon një marzh të kërkuar të kostos plus nga 20% në 25% (me një bazë të krahasueshme kostoje) atëherë mund të konkludohet se kushtet e transaksionit(ve) të kontrolluar (p.sh. shitja e rrobave nga shoqëria X tek shoqëria Y) janë në përputhje me parimin e tregut.*

Metoda e marzhit neto të transaksionit

8.4 Treguesi financiar i përshtatshëm për aplikimin e metodës së marzhit neto të transaksionit, siç përcaktohet në nenin 34, paragrafi 1, shkronja "ç" të ligjit, është fitimi neto mbi një bazë të përshtatshme. Treguesit financiarë gjatë aplikimit të metodës së marzhit neto të transaksionit mund të përfshijnë, por pa u kufizuar në:

a) raportin e fitimit neto (përpara interesave dhe taksave) ndaj shitjeve;

b) raportin e fitimit neto (përpara interesave dhe taksave) ndaj kostove totale (duke përfshirë kostot direkte, indirekte dhe operative);

c) raportin e fitimit neto përpara taksave ndaj kapitalit aksionar;

d) raportin e fitimit neto përpara interesave dhe taksave ndaj aktiveve.

Përzgjedhja e treguesit financiar duhet të jetë në përputhje me analizën e krahasueshmërisë, duke përfshirë analizën funksionale. Për shembull, fitimi neto (përpara interesave dhe taksave) ndaj treguesit financiar të shitjeve përdoret gjerësisht kur transaksioni i kontrolluar është blerja e pasurisë materiale nga pala e testuar e cila më pas i shitet palëve të pavarura, dhe fitimi neto (përpara interesave dhe taksave) ndaj kostos totale përdoret gjerësisht kur transaksioni i kontrolluar është ofrimi i shërbimeve nga pala e testuar për një palë të lidhur. Në përcaktimin e fitimit neto duhet treguar kujdes për të përjashtuar çdo të ardhur ose shpenzim të jashtëzakonshëm.

Kur zbatohet metoda e marzhit neto të transaksionit është e rëndësishme të sigurohet që treguesi financiar është përcaktuar në një mënyrë të krahasueshme për transaksionet e krahasueshme të kontrolluara dhe të pakontrolluara. Krahasimi i marzhit neto me një bazë të përshtatshme mund të bëhet me marzhin neto të bazës së përshtatshme në transaksionet e krahasueshme të pakontrolluara të brendshme ose në transaksionet e krahasueshme të pakontrolluara të jashtme, në varësi të disponueshmërisë së informacionit dhe/ose ekzistencës së transaksioneve të tilla.

Shembulli 1*. Supozojmë se shoqëria X, rezidente në shtetin X, i ofron shërbime të teknologjisë së informacionit një pale të lidhur me të, shoqërisë Y, rezidente në shtetin Y. Një kërkim për ofruesit e krahasueshëm të pavarur të shërbimeve që operojnë në shtetin X identifikoi 9 ofrues të pavarur të shërbimeve të teknologjisë së informacionit me marzh mbi koston totale (p.sh. një raport i fitimit neto (përpara interesave dhe taksave) ndaj kostove totale (direkte, indirekte dhe operative) që variojnë nga 6% në 9%. Një analizë krahasueshmërie tregon se nuk ka diferenca të rëndësishme të cilat do të ndikonin në mënyrë materiale marzhin ndaj kostove totale. Për rrjedhojë, duke supozuar se metoda e marzhit neto të transaksioneve që përdor një tregues financiar bazuar në kosto, është metoda më e përshtatshme, nëse shoqëria X aplikon një marzh ndaj kostove totale nga 6% në 9%, ndaj kostove që lidhen me ofrimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit tek Shoqëria Y, atëherë mund të konkludohet se kushtet e transaksionit(ve) të kontrolluar (p.sh. shërbimi i faturuar nga Shoqëria X tek Shoqëria Y) janë në përputhje me parimin e tregut.*

Shembulli 2*. Shoqëria X, rezidente në shtetin X, prodhon produkte kancelarie duke përdorur teknologjinë dhe markën tregtare që ka zhvilluar vetë dhe i shet këto produkte te një palë e lidhur me të, shoqëria Y, e cila është rezidente në shtetin Y. Shoqëria Y shpërndan pajisjet e palëvizshme në tregun e shtetit Y te palë të pavarura dhe nuk ndërmerr ndonjë funksion të rëndësishëm për shtimin e vlerës. Një kërkim për shpërndarësit e krahasueshëm të pavarur që operojnë në shtetin Y identifikoi 6 shpërndarës të pavarur me fitim neto (përpara interesave dhe taksave) ndaj shkallës së shitjeve që variojnë nga 2% në 5%. Një analizë krahasueshmërie tregon se nuk ka diferenca të rëndësishme të cilat do të ndikonin në mënyrë material fitimin neto (përpara interesave dhe taksave) ndaj shkallës së shitjeve. Për rrjedhojë, duke supozuar se metoda e marzhit neto, duke përdorur një tregues financiar*

bazuar në shitje, është metoda më e përshtatshme, nëse shoqëria Y merr një fitim neto (përpara interesave dhe taksave) ndaj shkallës së shitjeve nga 2% në 5%, atëherë mund të konkludohet se kushtet e transaksionit(ve) të kontrolluar (p.sh. shitjet e produkteve nga shoqëria X tek shoqëria Y) janë në përputhje me parimin e tregut.

Metoda e ndarjes së fitimit

8.5 Kur zbatohet metoda e ndarjes së fitimit, siç përcaktohet në nenin 34, paragrafi 1 të ligjit, nënparagrafi "d", kur është e mundur të përcaktohet qëndrueshmëria me parimin e tregut, për disa nga funksionet e kryera nga palët në lidhje me transaksionin(et) e kontrolluar(a) që përdorin njërën nga metodat e transferimit të çmimit të përshkruara, në nenin 34, paragrafi 1, nënparagrafët "a"-"d" të ligjit, metoda e ndarjes së fitimit për transaksionet do të aplikohet bazuar në fitimin (ose humbjen) e përbashkët të mbetur që rezulton kur këto funksione shpërblehen në këtë mënyrë. Në shpërndarjen e fitimit (ose humbjes) së mbetur, kriteri i përdorur për të arritur një shpërndarje në përputhje me parimin e tregut do të varet nga faktet dhe rrethanat e rastit, duke marrë në konsideratë se kriteri (ose faktori i shpërndarjes) duhet të bazohet në të dhëna objektive (p.sh. shitjet në palë të pavarura ose shpenzimet e paguara palëve të pavarura) dhe jo të dhëna të lidhura me transaksionet e kontrolluara (p.sh. shitjet te palët e lidhura) dhe duhet, sa më shumë që të jetë e mundur, të mbështetet në të dhëna të krahasueshme, të dhëna të brendshme, ose të dyja.

8.6 Kur nuk është e mundur të përcaktohet një shpërblim që është në përputhje me parimin e tregut për disa nga funksionet e kryera nga palët në lidhje me transaksionin e kontrolluar, metoda e ndarjes së fitimit mund të zbatohet bazuar në një analizë të kontributit.

Metoda të tjera

8.7 Në përputhje me nenin 34, paragrafi 2 të ligjit, një tatimpagues mundet që në rrethana të caktuara të zbatojë një metodë të transferimit të çmimit të ndryshme nga ndonjë nga metodat e aprovuara, të tilla si për shembull, një aktualizim të flukseve të parasë ose teknika vlerësimi.

9. Përzgjedhja e metodës së transferimit të çmimit

9.1 Për qëllime të nenit 34, paragrafi 1 të ligjit, metoda më e përshtatshme për transferimin e çmimit do të përzgjidhet duke marrë në konsideratë kriteret e mëposhtme:

a) Fuqitë dhe dobësitë përkatëse të metodave të aprovuara të transferimit të çmimit;

b) Përshtatshmëria e një metode të aprovuar të transferimit të çmimit në funksion të natyrës së transaksionit të kontrolluar, përcaktohet veçanërisht nëpërmjet një analize të funksioneve të kryera nga çdo shoqëri në transaksionin e rregulluar (duke marrë në konsideratë asetet e përdorura dhe risqet e marra përsipër);

c) Disponueshmëria e informacionit të besueshëm të nevojshëm për zbatimin e metodës së zgjedhur të transferimit të çmimit dhe/ose metodave të tjera; dhe

d) Shkallën e krahasueshmërisë midis transaksioneve të kontrolluara dhe të pakontrolluara, duke përfshirë besueshmërinë e rregullimeve të krahasueshmërisë, nëse ka, që mund të kërkohen për të eliminuar diferencat midis tyre.

9.2 Sipas nenit 34, paragrafi 3 të ligjit, një tatimpaguesi nuk i kërkohet të përcaktojë përputhshmërinë e kushteve të një transaksioni të kontrolluar me parimin e tregut duke aplikuar më shumë se një metodë. Kërkesa sipas nenit 34 është që përputhshmëria me parimin e tregut duhet të arrihet duke zbatuar metodën më të përshtatshme. Megjithatë tatimpaguesi ka të drejtë të kryqëzojë ose të mbështesë zbatimin e metodës më të përshtatshme nëpërmjet zbatimit të një ose më shumë prej metodave shtesë të transferimit të çmimit.

9.3 Kur një tatimpagues ka zbatuar njërën nga metodat e transferimit të çmimit të përcaktuar në nenin 34, paragrafi 1, sipas nenit 34, paragrafi 4 të ligjit, kontrolli i autoriteteve tatimore për faktin nëse kushtet e transaksionit të kontrolluar janë në përputhje me parimin e tregut, do të bazohet në metodën e transferimit të çmimit të zbatuar nga tatimpaguesi, përveçse nëse provohet nga autoriteti tatimor se metoda e zbatuar nga tatimpaguesi nuk është metoda më e përshtatshme.

10. Përzgjedhja e palës së testuar

10.1 Në aplikimin e metodës "kosto plus", metodës së çmimit të rishitjes ose metodës së marzhit neto të transaksionit, është e rëndësishme të përzgjidhet një palë e testuar. Pala e testuar duhet të jetë palë në transaksionin e kontrolluar për të cilin treguesi financiar po testohet.

10.2 Përzgjedhja e palës së testuar duhet të jetë në përputhje me analizën funksionale të transaksionit(ve) të kontrolluar. Si rregull i

përgjithshëm, pala e testuar është palë në transaksionin e kontrolluar për të cilin njëra nga metodat e transferimit të çmimit në nenin 34, paragrafi 1 të ligjit, mund të zbatohet në mënyrën më të besueshme dhe për të cilën transaksionet më të besueshme të krahasueshme të pakontrolluara mund të identifikohen, p.sh. më shpesh ajo do të jetë pala që ka funksionet më pak komplekse në lidhje me transaksionet e kontrolluara dhe nuk kontribuon me ndonjë aset jomaterial të vlefshëm.

10.3 Përdorimi i një pale të testuar të huaj, për shembull një palë e testuar që nuk është tatimpaguese shqiptare, do të pranohet nga autoritetet tatimore, me kusht që të jenë përmbushur kërkesat e mëposhtme:

a) metoda e zbatuar e transferimit të çmimit të jetë njëra nga metodat e aprovuara të transferimit të çmimit që është metoda më e përshtatshme e transferimit të çmimit;

b) pala e testuar të jetë përzgjedhur në përputhje me këtë pikë; dhe

c) tatimpaguesi vendos në dispozicion të autoriteteve tatimore informacionin e mjaftueshëm në lidhje me palën e testuar në mënyrë që të lejojë një vlerësim ku kushtet e transaksioneve të kontrolluara të jenë në përputhje me parimin e tregut.

11. Llojet specifike të transaksioneve

Transaksionet e shërbimit

11.1 Një pagesë për një transaksion të kontrolluar, që është ofrimi ose marrja e një shërbimi, do të konsiderohet në përputhje me parimin e tregut kur:

a) është paguar për një shërbim që është dhënë në fakt;

b) shërbimi ofron, ose kur pritej të ofronte për marrësin, një vlerë ekonomike ose tregtare për të përmirësuar pozicionin e tij tregtar;

c) është paguar për një shërbim që një palë e pavarur në rrethana të krahasueshme do të kishte qenë e gatshme të paguante për të nëse do të kryhej nga një palë e pavarur, ose do ta kishte kryer për vete; dhe

d) vlera e tij korrespondon me vlerën për të cilën duhet të ishte rënë dakord midis palëve të pavarura për shërbime të krahasueshme në rrethana të krahasueshme.

11.2 Kur është e mundur të identifikohen shërbimet specifike të ofruara nga njëra palë tek tjetra, përcaktimi nëse shërbimi i paguar është në përputhje me parimin e tregut, do të bëhet për çdo shërbim specifik.

11.3 Kur shërbime të veçanta ofrohen nga njëra palë për palë të ndryshme të lidhura dhe jo për ndonjë palë të pavarur, dhe nuk është e mundur të identifikohen shërbimet specifike të ofruara secilës, shërbimi total i paguar do të shpërndahet, ndërmjet palëve të lidhura që përfitojnë ose presin të përfitojnë nga shërbimet, sipas kritereve të arsyeshme të shpërndarjes. Për qëllime të kësaj dispozite, kriteret e shpërndarjes do të shihen si të arsyeshme kur ato bazohen mbi një variabël ose variabla që:

a) marrin në konsideratë natyrën e shërbimeve, rrethanat në të cilat ato ofrohen dhe përfitimet e marra ose që pritej të merreshin nga palët për të cilat shërbimi ishte menduar;

b) lidhen ekskluzivisht me transaksione të pakontrolluara, më shumë se sa me transaksione të kontrolluara; dhe

c) janë të mundshme për të qenë të matshëm në një mënyrë të arsyeshme dhe të besueshme.

Transaksionet që përfshijnë asete jomateriale

11.4 Zbatimi i parimit të tregut për transaksionet e kontrolluara që përfshijnë licencat, shitjet ose transferta të tjera të pronave të paluajtshme do të marrë në konsideratë si perspektivën e transferuesit të pronës, ashtu dhe perspektivën e marrësit, duke përfshirë në veçanti çmimin në të cilin palë të krahasueshme të pavarura do të ishin të gatshme të transferonin pronën dhe vlerën dhe dobishmërinë e pronës jomateriale të marrësit në biznesin e tij.

11.5 Në vlerësimin e krahasueshmërisë në përputhje me nenin 33 të ligjit, për një transaksion që përfshin licencimin, shitjen ose transferime të tjera të pronave të paluajtshme, duhet t'i kushtohet vëmendje çdo faktori të veçantë të rëndësishëm për krahasueshmërinë e transaksioneve të kontrolluara dhe të pakontrolluara, duke përfshirë:

a) përfitime të pritshme nga pasuria jomateriale;

b) çdo kufizim gjeografik në ushtrimin e të drejtave të pronës jomateriale;

c) karakteri ekskluziv ose joekskluziv i të drejtave të transferuara; dhe

d) nëse marrësi ka të drejtë të marrë pjesë në zhvillime të mëtejshme të pronës jomateriale nga transferuesi.

12. Rregullimi i transferimit të çmimit

12.1 Një rregullim sipas nenit 32, paragrafi 1 të ligjit do të kryhet nga autoritetet tatimore vetëm me miratimin me shkrim të drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore.

12.2 Sipas nenit 32, paragrafi 1 dhe nenit 36 të ligjit, kur treguesi financiar që rrjedh nga transaksioni(et) i(e) kontrolluar(a) është jashtë gamës së tregut, autoriteti tatimor mund të kryejë një rregullim të fitimit të tatueshëm të tatimpaguesit për ta barazuar treguesin financiar me medianën e gamës së tregut, përveçse nëse autoriteti tatimor ose tatimpaguesi provon se rrethanat e rastit garantojnë rregullimin në një pikë të ndryshme të gamës së tregut.

12.3 Mediana e gamës së tregut është 50-të përqindëshi i rezultateve që rrjedh nga transaksionet e krahasueshme të pakontrolluara që formojnë gamën e tregut.

Për këtë qëllim, 50-të përqindëshi është rezultati më i ulët i tillë që 50 për qind e rezultateve janë nën vlerën e këtij rezultati. Gjithsesi, nëse ekzaktësisht 50 për qind e rezultateve janë në ose nën një rezultat, atëherë 50-të përqindëshi është i barabartë me kuptimin aritmetik të atij rezultati dhe rezultati pasardhës më i lartë i derivuar nga transaksionet e krahasueshme të pakontrolluara.

Shembulli 1

Nëse gama e tregut përbëhet nga 7 rezultate, mediana do të jetë rezultati i katërt kur këto rezultate renditen sipas rendit rritës. Nëse këto rezultate janë, për shembull, 2.8%, 2.9%, 2.9%, 3.0% 3.1%, 3.6% dhe 3.7%, mediana do të jetë 3.0%.

Shembulli 2

Nëse gama e tregut përbëhet nga 8 rezultate, mediana do të jetë mesatarja e rezultatit të katërt dhe të pestë, kur këto rezultate renditen sipas rendit rritës. Nëse këto rezultate janë, për shembull, 5.8%, 5.9%, 5.9%, 6.0% 7.1%, 7.6%, 7.7% dhe 7.7%, mediana do të jetë 6.55% ((6.0%+7.1%)/2).

12.4 Në mënyrë që të provohet se rrethanat e rastit garantojnë rregullimin në një pikë të gamës së tregut të ndryshme nga mediana, tatimpaguesi ose autoriteti tatimor, në varësi të rastit se cili është duke kërkuar rregullimin në një pikë të ndryshme të gamës së tregut, merr barrën e provës, për të provuar përse bazuar në fakte dhe rrethana specifike të rastit, rregullimi në këtë pikë tjetër do të reflektojë më mirë zbatimin e parimit të tregut.

12.5 Kontrolli i autoriteteve tatimore i një transaksioni të kontrolluar duhet zakonisht të bazohet në transaksionin e ndërmarrë aktualisht nga palët dhe që është strukturuar prej tyre. Në kryerjen e rregullimeve sipas nenit 36, paragrafi 3 të ligjit, autoritetet tatimore nuk duhet të anashkalojnë transaksionin aktual të ndërmarrë ose të zëvendësojnë transaksione të tjera, përveçse në raste përjashtimore, kur:

a) thelbi ekonomik i transaksionit të kontrolluar ndryshon nga forma e tij;

b) rregullimet e kryera në lidhje me transaksionin e kontrolluar, të para në tërësinë e tyre, ndryshojnë nga ato të cilat do të ishin pranuar nga palë të pavarura që veprojnë në një mënyrë tregtare racionale dhe struktura aktuale praktikisht pengon autoritetin tatimor të përcaktojë përputhshmërinë e parimit të tregut.

13. Rregullimet korresponduese

13.1 Kërkesa nga një tatimpagues për një rregullim korrespondues në përputhje me nenin 38 duhet të bëhet me shkrim në Drejtorinë Rajonale Tatimore dhe duhet të përfshijë informacionin e nevojshëm për autoritetin tatimor për shqyrtimin e përputhshmërisë së rregullimit të kryer nga administrata tatimore e vendit tjetër me parimin e tregut, duke përfshirë:

a) emrin, adresën e regjistruar dhe, kur është e aplikueshme, emrin(at) tregtar të palës së lidhur dhe detajet e regjistrimit;

b) vitin(et) në të cilin(ët) transaksionet e rregulluara kanë ndodhur;

c) vlerën e rregullimit përkatës të kërkuar dhe vlerat e rregullimeve të kryera nga administrata tatimore e partnerëve të marrëveshjes tatimore;

d) vërtetimin e rezidencës tatimore të palës së lidhur, për shembull një letër ose certifikatë rezidence e lëshuar nga administrata tatimore e vendit të partnerit të marrëveshjes tatimore;

e) vërtetimin e rregullimit të kryer nga administrata tatimore e partnerit të marrëveshjes tatimore dhe baza për rregullim, për shembull një kopje e vlerësimit dhe analizës mbështetëse dhe detaje të çdo apelimi administrativ ose procedure gjyqësore të ndërmarrë, kur është e aplikueshme;

f) detaje të faktorëve të krahasueshmërisë, metodën e aplikuar të transferimit të çmimit etj.;

g) konfirmimin se pala e lidhur nuk do të ndjekë, ose nuk ka mundësi të ndjekë, asnjë rekurs të mëtejshëm sipas ligjit të vendit të partnerit të

marrëveshjes tatimore, që mund të rezultojë në rregullimin e kryer nga administrata tatimore e partnerit të marrëveshjes tatimore që zvogëlohet ose anulohet;

h) çdo informacion tjetër që mund të jetë i rëndësishëm për të ekzaminuar përputhshmërinë e rregullimit me parimin e tregut.

13.2 Kërkesa duhet të kryhet në përputhje me dispozitat e marrëveshjes përkatëse për eliminimin e tatimeve të dyfishta dhe procedurave dhe afateve kohore të rëna dakord ndërmjet autoriteteve kompetente për zbatimin e marrëveshjes.

13.3 Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore, brenda 3 muajve nga data e marrjes së kërkesës që plotëson kushtet e mësipërme, do të njoftojë tatimpaguesin nëse rregullimet korresponduese të kërkuara do të kryhen ose jo, pjesërisht ose tërësisht, në përputhje me nenin 38 të ligjit.

13.4 Kur drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore, në përputhje me afatin e përcaktuar në pikën 13.3, ka refuzuar kërkesën e tatimpaguesit për një rregullim korrespondues, pjesërisht ose tërësisht, arsyeja për këtë vendim duhet t'i dërgohet tatimpaguesit me shkrim. Këto arsye mund të përfshijnë, por pa u kufizuar në:

a) kërkesa e bërë nuk përmbushte kushtet e pikës 13;

b) tatimpaguesi nuk ka arritur të vendosë në dispozicion të autoriteteve tatimore informacionin e nevojshëm për ta, për të ekzaminuar përputhshmërinë e rregullimit me parimin e tregut;

c) autoriteti tatimor, bazuar në vlerësimin e tij të informacionit që i është vënë në dispozicion, është i mendimit se rregullimi i kryer nga administrata tatimore e vendit tjetër nuk është në përputhje me parimin e tregut, dhe jep një shpjegim për këtë efekt.

13.5 Kërkesa e tatimpaguesit për një rregullim korrespondues në përputhje me nenin 38 të ligjit, nuk i kufizon të drejtat e tatimpaguesit për të kërkuar çlirim nga tatimi i dyfishtë në përputhje me dispozitat e marrëveshjes tatimore të aplikueshme (p.sh. nëpërmjet procedurave të marrëveshjeve të përbashkëta).

14. Njoftimi për transaksionet e kontrolluara

14.1 Sipas nenit 37, paragrafi 2 të ligjit, tatimpaguesit e përfshirë në transaksione të kontrolluara (duke përfshirë tepricat e huave), të cilat në total, brenda periudhës raportuese kalojnë 50,000,000 (pesëdhjetë milionë) lekë, duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në drejtorinë rajonale tatimore në të cilën janë të regjistruar, një "Njoftim vjetor për transaksionet e kontrolluara". Në përcaktimin e transaksioneve totale, të ardhurat dhe shpenzimet nuk mund të përjashtohen.

14.2 Forma dhe përmbajtja e "Njoftimit vjetor për transaksionet e kontrolluara" specifikohet në aneksin 2 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi. Ai mund të dorëzohet dorazi bashkë me bilancin dhe pasqyrat financiare, ose në rrugë elektronike, siç kërkohet nga autoriteti tatimore.

14.3 Afati për dorëzimin e "Njoftimit vjetor për transaksionet e kontrolluara" është data e përcaktuar për dorëzimin e "Formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi fitimin".

15. Dokumentacioni për transferimin e çmimit

15.1 Neni 37 i ligjit kërkon që tatimpaguesit të përgatisin dhe paraqesin informacion të mjaftueshëm dhe analiza për të verifikuar që kushtet e transaksioneve të tyre të kontrolluara janë në përputhje me parimin e tregut, pra kanë barrën e provës fillestare për të vërtetuar se kushtet në transaksionet e tyre të kontrolluara janë në përputhje me parimin e tregut të tatimpaguesit. Kjo barrë do të konsiderohet e përfunduar kur tatimpaguesi të ketë përgatitur dokumentacionin e transferimit të çmimit në përputhje me këtë udhëzim.

15.2 Kur një tatimpagues ka përgatitur dokumentacionin në përputhje me këtë udhëzim dhe e ka paraqitur në autoritetin tatimor brenda 45 ditëve nga data e kërkesës së bërë, ky tatimpagues do të përjashtohet nga penaliteti i vendosur sipas nenit 115/1, paragrafi 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Përgatitja dhe paraqitja e dokumentacionit të transferimit të çmimit nuk do të ndalojë autoritetin tatimor për të bërë një rregullim për efekt të transferimit të çmimit sipas nenit 32, paragrafi 1 të ligjit, kur autoriteti tatimor mund të provojë se kushtet e transaksionit(ve) të kontrolluar nuk janë në përputhje me parimin e tregut.

15.3 Dokumentacioni i transferimit të çmimit duhet të përfshijë sa vijon:

a) Përmbledhje të operacioneve të biznesit të tatimpaguesit (historia, zhvillimet e fundit dhe një përshkrim të përgjithshëm të tregjeve përkatëse të referencës) dhe skemën organizative (detaje të grupit në të cilin tatimpaguesi është anëtar (duke përfshirë detajet e të gjithë anëtarëve të grupit, formën ligjore të tyre dhe përqindjet e tyre të pjesëmarrjes) dhe

strukturën operative të grupit (duke përfshirë një përshkrim të përgjithshëm të rolit që secili anëtar i grupit ka në lidhje me aktivitetet e grupit, si të lidhura me transaksionin(et) e kontrolluar(a);

b) Përshkrimin e transaksionit(eve) të kontrolluar(a), duke përfshirë analizën e faktorëve të krahasueshmërisë të specifikuar në nenin 33, paragrafi 2 të ligjit, dhe detaje të politikave të zbatuara të transferimit të çmimit (atëherë kur është e nevojshme);

c) Shpjegimin e përzgjedhjes së metodës(ave) më të përshtatshme të transferimit të çmimit, dhe, atëherë kur është e nevojshme, të treguesit financiar;

d) Analizën e krahasueshmërisë, duke përfshirë: përshkrimin e procesit të kryer për të identifikuar transaksionet e krahasueshme të pakontrolluara; shpjegimin e bazës për refuzimin e ndonjë transaksioni potencial të brendshëm të krahasueshëm të pakontrolluar (kur është e zbatueshme); përshkrimin e transaksioneve të krahasueshme të pakontrolluara; analizën e krahasueshmërisë së transaksionit(eve) të kontrolluar(a) dhe transaksioneve të krahasueshme të pakontrolluara (duke marrë në konsideratë nenin 33 të ligjit); dhe detajimin dhe shpjegimet e çdo rregullimi të kryer të krahasueshmërisë;

e) Shpjegimin e çdo analize ekonomike dhe projekti mbështetës;

f) Detaje mbi çdo marrëveshje paraprake të çmimit, ose marrëveshje të ngjashme në vende të tjera, të zbatueshme në transaksionet e kontrolluara;

g) Konkluzionin për përputhshmërinë e kushteve të transaksioneve të kontrolluara me parimin e tregut, duke përfshirë detajet e çdo rregullimi të kryer për arritjen e përputhshmërisë;

h) Çdo informacion tjetër që mund të ketë një ndikim material në përcaktimin e përputhshmërisë së tatimpaguesit me parimin e tregut në lidhje me transaksionet e kontrolluara.

15.4 Dokumentacioni i transferimit të çmimit i përgatitur sipas kërkesave të detajuara në Kodin e Sjelljes të Bashkimit Evropian (BE) dhe anekset përkatëse të tij mbi dokumentacionin e transferimit të çmimit për shoqëritë e lidhura, të miratuara nga rezoluta 2006/c176/01, e datës 27 qershor 2006, nga Këshilli i BE-së dhe përfaqësuesit e qeverive të Shteteve Anëtare, do të konsiderohet se përmbush kërkesat e nenit 37 të ligjit të dhëna në "Masterfile" dhe në "Dokumentacionin specifik të shtetit" për Shqipërinë (ku adresohet informacioni i përshkruar në Kodin e Sjelljes të sipër-përmendur) përgatitet dhe paraqitet në autoritetin tatimor brenda 45 ditëve nga data e kërkesës.

15.5 Tatimpaguesit me transaksione të kontrolluara nën shumën totale prej 50,000,000 (pesëdhjetë milionë) lekësh do të konsiderohen se përmbushin kërkesat për dokumentacionin e transferimit të çmimit, edhe kur në rastin e përdorimit të transaksioneve të jashtme të krahasueshme, seria e transaksioneve të jashtme të krahasueshme të pakontrolluara, përditësohen vetëm një herë në tre periudha raportuese, me kusht që nuk ka pasur ndryshime materiale në transaksionet e kontrolluara, transaksionet e krahasueshme të pakontrolluara të jashtme ose rrethanat ekonomike përkatëse.

15.6 Dokumentacioni i transferimit të çmimit duhet të dorëzohet në gjuhën shqipe ose angleze. Gjithsesi, kur dokumentacioni është dorëzuar në gjuhën angleze, në vijim të kërkesës për përkthim nga administrata tatimore, duhet të jetë i shoqëruar me përkthimin e legalizuar në gjuhën shqipe. Shpenzimi i përkthimit mbulohet nga tatimpaguesi shqiptar dhe duhet të dorëzohet brenda 45 ditëve nga kërkesa për përkthim.

15.7 Dokumentacioni i transferimit të çmimit mund të dorëzohet si në format elektronik, ashtu edhe në letër.

15.8 Tatimpaguesi nuk konsiderohet të ketë përmbushur kërkesat e nenit 37 të ligjit nëse dokumentacioni i transferimit të çmimit i vendosur në dispozicion është i paplotë, përmban informacion të rremë ose fakte të pasakta ose lë jashtë fakte apo informacione të lidhura me çështjen.

- MARRËVESHJET E ÇMIMIT NË AVANCË (MÇA)

16. Marrëveshjet e Çmimit në Avancë (MÇA) dhe llojet e tyre

16.1 "Marrëveshje Çmimi në Avancë" (MÇA) është një marrëveshje procedurale ndërmjet një apo më shumë tatimpaguesve dhe një apo më shumë administratave tatimore, me qëllim zgjidhjen në avancë të mosmarrëveshjeve të mundshme të transferimit të çmimit, duke përcaktuar para kryerjes së transaksioneve të kontrolluara, një grup kriteresh të përshtatshme për përcaktimin e përputhshmërisë së këtyre transaksioneve me parimin e tregut.

16.2 Llojet e marrëveshjeve që mbulohen nga ky udhëzim përfshijnë:

a) Marrëveshjet e Njëanshme të Çmimit në Avancë – përmes të cilave lidhet një marrëveshje ndërmjet një tatimpaguesi dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) në lidhje me zbatimin e nenit 3, paragrafi 13, neneve 32–39, dhe nenit 44, të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, për transaksionet e kontrolluara të specifikuara.

b) Marrëveshjet Dypalëshe të Çmimit në Avancë – përmes të cilave një tatimpagues kërkon që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të arrijë marrëveshje me një partner të konventës së shmangies së tatimit të dyfishtë (autoriteti tatimor i shtetit tjetër kontraktues) në lidhje me zbatimin e nenit mbi ndërmarrjet e lidhura, të konventës përkatëse të shmangies së tatimit të dyfishtë në transaksionet e kontrolluara të specifikuara.

c) Marrëveshjet Shumëpalëshe të Çmimit në Avancë – përmes të cilave një tatimpagues kërkon që *Drejtoria* e Përgjithshme e Tatimeve të arrijë marrëveshje me dy apo më shumë partnerë të konventës së shmangies së tatimit të dyfishtë në lidhje me aplikimin e neneve mbi ndërmarrjet e lidhura për transaksionet e kontrolluara të specifikuara.

16.3 Kur një marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe e çmimit në avancë e nënshkruar ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe një apo më shumë partnerëve të konventave tatimore të tatimit të dyfishtë hyn në fuqi, kjo *marrëveshje reciproke* (në bazë të nenit mbi procedurën e marrëveshjes reciproke të konventës përkatëse tatimore) do të jetë bazë për Marrëveshjen e Çmimit në Avancë në Shqipëri dhe në përputhje me këtë marrëveshje.

16.4 Shkronjat (b) dhe (c), të pikës 16.2, janë të zbatueshme vetëm në rastet kur një apo më shumë konventa tatimore, apo konventa të ngjashme, janë të zbatueshme, dhe konventat në fjalë përmbajnë dispozitat në lidhje me ndërmarrjet e lidhura.

17. Garancia e dhënë nga Marrëveshjet e Çmimit në Avancë

17.1 Në zbatim të nenit 39, pika 2, të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, kur një tatimpagues ka hyrë në një Marrëveshje të Çmimit në Avancë, asnjë rregullim nuk do të bëhet në përputhje me nenin 32, pika 1, të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat", te transaksionet e kontrolluara të specifikuara, me kushtin që të jenë plotësuar afatet dhe kushtet e Marrëveshjes së Çmimit në Avancë.

17.2 Përveçse në rrethana të veçanta, Marrëveshjet e Çmimit në Avancë nuk kanë për qëllim të përcaktojnë fitimet e tatueshme apo të ardhurat për t'u tatuar në Shqipëri. Marrëveshjet e Çmimit në Avancë do të specifikojnë dhe përcaktojnë një sërë kriteresh të përshtatshme (p.sh. metodën e transferimit të çmimit, krahasueshmëritë apo faktorët e krahasueshmërisë dhe rregullimet e përshtatshme mbi to, supozimet kritike për sa u përket ngjarjeve të ardhshme) në përputhje me parimin e palëve të pavarura për ato transaksione të kontrolluara gjatë një periudhe të caktuar kohe.

18. Pritshmëritë dypalëshe të tatimpaguesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

18.1 Pritshmëritë e përbashkëta të tatimpaguesit dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, kur ato janë të nevojshme, parashikohen në aneksin 3 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Mungesa e plotësimit të pritshmërive të përbashkëta, qoftë nga DPT-ja apo tatimpaguesi, mund të rezultojnë në përfundimin apo revokimin e procesit të MÇA-së, qoftë nga ana e DPT-së, apo edhe nga ana e tatimpaguesit.

19. Pranueshmëria

19.1 Kërkesat e çmimit në avancë do të merren në konsideratë nëse transaksionet e kontrolluara për të gjithë periudhën që do të mbulojë marrëveshja, tejkalojnë në shumë totale vlerën prej 30,000,000 (tridhjetë milionë) euro. Pra, nëse do të kemi një marrëveshje për periudhë 3-vjeçare, shuma e transaksioneve me palët e lidhura duhet të kalojë 30,000,000 (tridhjetë milionë) euro për të tre vjetët të marrë së bashku. Nëse do të kemi një marrëveshje për një periudhë 5-vjeçare, shuma e transaksioneve me palët e lidhura duhet të kalojë 30,000,000 (tridhjetë milionë) euro për të pesë vitet e marrë së bashku.

19.2 Kur transaksionet e kontrolluara të parashikuara për t'u mbuluar nga marrëveshja nuk e tejkalojnë shumën e parashikuar në pikën 19.1, kërkesat mund të pranohen nga DPT-ja, me kushtin që rasti është mjaftueshmërisht kompleks ose është i një rëndësie të lartë tregtare apo ekonomike për Shqipërinë.

20. Pagesa e komisionit të aplikimit

20.1 Aplikimi për një marrëveshje të çmimit në avancë i paraqitur sipas pikës 25 të këtij udhëzimi, shoqërohet me një pagesë të pakthyeshme prej 50,000 lekësh.

20.2 Me përfundimin e fazës 1 të procedurës së MÇA-së, në përputhje me pikën 23.1, në momentin e fillimit të fazës 2, aplikimit zyrtar, tatimpaguesi duhet të ketë paguar tarifën administrative si më poshtë:

a) në rastin e një marrëveshje të njëanshme të çmimit në avancë, 300,000 lekë;

b) në rastin e një marrëveshje dypalëshe të çmimit në avancë, 1,200,000 lekë; dhe

c) në rastin e një marrëveshje shumëpalëshe të çmimit në avancë, 1,200,000 lekë.

20.3 Në rastet kur DPT-ja, pas analizimit paraprak të dokumentacionit, me përfundimin e fazës 2 dhe 3 sipas pikës 23.1 të këtij udhëzimi, refuzon aplikimin në rrugë zyrtare, atëherë DPT-ja i rimburson tatimpaguesit 90% të tarifës së paguar sipas pikës 20.2 më lart, brenda 30 ditëve nga data e refuzimit.

20.4 Pagesa e tarifës nuk i heq të drejtën tatimpaguesit të tërhiqet nga procesi i marrëveshjes së çmimit në avancë, ose të drejtën DPT-së për t'u tërhequr nga bisedimet, në zbatim të pikës 30 të këtij udhëzimi.

20.5 Me pranimin e kërkesës së tatimpaguesit për marrëveshjen e çmimit në avancë dhe fillimin e negociatave sipas pikës 23.1, faza 4, "Negocimi", pagesa e tarifës së aplikimit nuk i kthehet tatimpaguesit për asnjë rrethanë.

20.6 Tarifat e përcaktuara në këtë dispozitë paguhen nga tatimpaguesit në emër të DPT-së, në llogarinë e të ardhurave të thesarit, të Degës së Thesarit Tiranë, në klasën 46655, "Depozitime të përkohshme për marrëdhëniet me Administratën Tatimore", në llogarinë ekonomike 4665501, "Depozitime të përkohshme nga tarifat e aplikimit të Marrëveshjeve të Çmimit në Avancë". Për këtë tatimpaguesi do të plotësojë faturën për arkëtim, me formatin ekzistues, të cilin e paraqet në bankë në momentin e pagesës. Dega e Thesarit bën kontabilizimin e transaksionit duke e evidentuar atë për çdo tatimpagues (në nënllogarinë teknike të çelur specifikisht në SIFQ për çdo tatimpagues).

3.DPT-ja rakordon rregullisht, në mbyllje të periudhës kontabël ose përpara saj nëse është e domosdoshme, me Degën e Thesarit Tiranë, dhe shumat nga tarifat që nuk i kthehen tatimpaguesve, do t'i transferojnë në llogarinë përkatëse të të ardhurave nëpërmjet metodës së xhirimeve të brendshme brenda institucionit. Këto shuma përdoren nga DPT-ja vetëm në funksion të administrimit të procesit të negocimit dhe zbatimit të Marrëveshjeve të Çmimit në Avancë.

4.**21. Periudha maksimale e mbulimit**

21.1 Data e fillimit e MÇA-së duhet të jetë viti fiskal që vijon datën e nënshkrimit të marrëveshjes.

21.2 Periudha maksimale e mbulimit për Marrëveshjet e Çmimit në Avancë është 5 (pesë) vjet, me përjashtim të rasteve kur Marrëveshja e Çmimit në Avancë i përket zbatimit të një marrëveshje reciproke qeveritare të ratifikuar me ligj.

21.3 Tatimpaguesit nuk mund të kërkojnë një MÇA për një periudhë të mbuluar të disa viteve të mëparshme (referuar si "rikthimi viteve".) Megjithatë, në kuptimin që MÇA-ja është nënshkruar dhe përfunduar pas vitit të parë fiskal të MÇA-së së propozuar, viti fiskal gjatë të cilit është propozuar MÇA-ja do të mbulohet nga marrëveshja.

22. Fusha e kërkesës dhe trajtimi i çështjeve anësore

22.1 Fusha e kërkesës kufizohet te marrëveshjet në lidhje me zbatimin e parimit të palëve të pavarura në transaksionet e kontrolluara.

22.2 Kur transaksionet e kontrolluara që do të mbulohen nga MÇA-ja, mbulohen nga një konventë tatimore në zbatim, aplikimet duhet të bëhen për MÇA-në dypalëshe ose shumëpalëshe. Aplikimet për MÇA-të e njëanshme në raste të tilla do të pranohen vetëm në raste të veçanta (p.sh. kur partneri i konventës tatimore nuk dëshiron të hyjë në negociata).

22.3 Në rastet kur çështjet indirekte (të tilla si: zbritshmëria e shpenzimeve, zbatueshmëria e tatimit në burim, ekzistenca e selisë së përhershme, atribuimi i fitimit te njësia e përhershme etj.) identifikohen në fazën e paradorëzimit, fazën e aplikimit apo vlerësimit, këto çështje mund t'i paraqiten DPT-së për t'u marrë në konsideratë për hartimin e një marrëveshje në avancë, në pajtueshmëri me nenin 39 të ligjit. Çështjet indirekte nuk do të trajtohen në vetë Marrëveshjen e Çmimit në Avancë dhe marrëveshja do të negociohet apo do të hyjë në fuqi pavarësisht çështjeve të tilla.

22.4 DPT-ja ka të drejtën të shtojë në kërkesën e Marrëveshjes së Çmimit në Avancë të tatimpaguesit, transaksione të tjera që do të mbulohen nga marrëveshja, në rastet kur transaksionet janë të ndërlidhura në mënyrë të tillë që duhen analizuar së bashku.

23. Procedura e MÇA-së (Marrëveshjes së Çmimit në Avancë)

23.1 Procedura e Marrëveshjes së Çmimit në Avancë në Shqipëri përfshin 6 faza:

Faza 1 – Takimi i paradorëzimit të kërkesës;

Faza 2 – Aplikimi zyrtar;

Faza 3 – Vlerësimi;

Faza 4 – Negocimi;

Faza 5 – Hartimi dhe marrëveshja;

Faza 6 – Raporti vjetor i pajtueshmërisë.

23.2 Secila prej 6 fazave trajtohet në detaje në pikat 24–29 të këtij udhëzimi.

24. Takimi paradorëzimit të kërkesës (faza 1)

24.1 Procedura e MÇA-së fillon me zhvillimin e takimeve paradorëzimit. Qëllimi i këtyre takimeve është t'i lejojë të gjitha palëve të vlerësojnë suksesin e marrëveshjes së propozuar të çmimit në avancë. Ajo lejon DPT-në që të bëjë një gjykim paraprak nëse aplikimi do jetë i pranueshëm, si dhe të qartësojë pritshmëritë e të dyja palëve.

24.2 Për të mundësuar vlerësimin e suksesit të marrëveshjes shqiptare të çmimit në avancë të propozuar, bëhen takime para dorëzimit të dosjes në përputhje me formularin e pyetësorit të para dorëzimit të specifikuar në aneksin 4.

24.3 Mbledhjet e paradorëzimit mbahen në baza konfidenciale nëse sigurohet informacion i mjaftueshëm nga tatimpaguesi ose përfaqësuesi i tyre, si pjesë e pyetësorit të paradorëzimit të aneksit 4.

24.4 Me marrjen e pyetësorit të paradorëzimit, DPT-ja do të kontaktojë tatimpaguesin ose përfaqësuesin e tij për të diskutuar për kohën dhe vendin e takimit. Takimet duhet të mbahen brenda 60 ditëve nga paraqitja e kërkesës për takimin e paradorëzimit, përveçse kur palët bien dakord ndryshe.

24.5 Materialet shtesë apo dosja për prezantimin në takimin e paradorëzimit, do t'i dërgohen DPT-së të paktën një javë para takimit. Në rast të kundërt takimi mund të riplanifikohet.

24.6 Çdo deklaratë ose paraqitje e bërë gjatë takimit të paradorëzimit nga DPT-ja përbën këshillë jo zyrtare lidhur me aplikimin e propozuar dhe nuk është detyruese për DPT-në.

24.7 Nëse gjatë takimeve të paradorëzimit përcaktohet që aplikimi për MÇA-në i tatimpaguesit, që do t'i nënshtrohet pikës 25 të këtij udhëzimi, është i pranueshëm për DPT-në, tatimpaguesi duhet të informohet me shkrim brenda 60 ditëve nga takimi i paradorëzimit.

24.8 Nëse gjatë takimeve të paradorëzimit, përcaktohet se aplikimi për MÇA-në i tatimpaguesit nuk pranohet nga DPT-ja, tatimpaguesi informohet me shkrim brenda 30 ditëve nga mbledhja e paradorëzimit duke dhënë edhe arsyet e mospranimit të aplikimit, siç ishte përcaktuar në takimin e paradorëzimit. Arsyet e mundshme të papranueshmërisë së aplikimit për MÇA-në, janë si më poshtë vijon:

24.8.1 transaksionet e propozuara për t'u mbuluar nga Marrëveshja e Çmimit në Avancë nuk konsiderohen si të përshtatshme për një Marrëveshje të Çmimit në Avancë;

24.8.2 tatimpaguesi paraqet risk për mospërmbushje të detyrimeve; ose

24.8.3 ka çështje të tjera komplekse që kërkojnë rizgjidhje paraprake përpara konsiderimit të Marrëveshjes së Çmimit në Avancë (p.sh. ekzistenca e një selie të përhershme dhe konsiderata të tjera materiale).

24.9 Nëse gjatë takimeve të paradorëzimit përcaktohet se kërkohet informacion shtesë përpara se aplikimi për MÇA-në nga tatimpaguesi të mund të pranohet nga DPT-ja, tatimpaguesi do të informohet me shkrim mbi informacionin shtesë të kërkuar dhe tatimpaguesit do t'i jepen mundësitë e arsyeshme për ta prezantuar informacionin e kërkuar brenda 30 ditëve, para se të bëhet njoftimi sipas pikës 24.7 apo pikës 24.8.

25. Aplikimi zyrtar (faza 2)

25.1 Nëse tatimpaguesi ka si qëllim të procedojë me një aplikim zyrtar për një Marrëveshje Çmimi në Avancë, siç parashikohet në takimin e paradorëzimit, aplikimi për një Marrëveshje Çmimi në Avancë bëhet në përputhje me informacionin e paraqitur në aneksin 5, duke marrë në konsideratë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në pikën 19 të këtij udhëzimi.

25.2 Nëse kërkesa bëhet për një MÇA dypalëshe ose shumëpalëshe, tatimpaguesi duhet të dorëzojë aplikimin në të njëjtën kohë tek autoritetet kompetente të të gjitha juridiksioneve të huaja tatimore, në të gjitha rastet.

25.3 DPT-ja do të pranojë marrjen e aplikimit zyrtar të MÇA-së me shkrim nëpërmjet një shkrese informuese brenda 60 ditëve nga konfirmimi i marrjes së aplikimit në zyrën e DPT-së. Shkresa

informuese duhet të njoftojë nëse aplikimi është pranuar ose jo.

25.4 Nëse aplikimi pranohet, letra informuese do të përmbajë informacionet si më poshtë vijon:

1) nëse aplikimi për MÇA-në reflekton mirëkuptimin e DPT-së në takimin e paradorëzimit;

2) nëse aplikimi për MÇA-në është në thelb i plotësuar, bazuar në informacionin e kërkuar, të përcaktuar në aneksin 5;

3) tarifa përkatëse e aplikimit për MÇA-në është paguar dhe pranuar; dhe

4) të dhënat e personit/personave të kontaktit të DPT-së të caktuar për vlerësimin e aplikimit.

25.5 Nëse aplikimi refuzohet, shkresa informuese do të përmbajë arsyet e refuzimit.

25.6 Në rastet kur aplikimi nuk i përmbush kërkesat e aneksit 5, shkresa informuese jep ndryshimet e kërkuara për procedimin e aplikimit në vlerësimin e MÇA-së.

25.7 Një pranim i aplikimit për një MÇA, nuk sugjeron apo përcakton me siguri që DPT-ja dhe tatimpaguesi do të përfundojnë MÇA, apo të sigurojë se do të përdoren metodat e propozuara. Megjithatë, një aplikim i pranuar i MÇA-së nënkupton që DPT-ja do të ndërmarrë procedurat, sikurse parashikohen në pikat 25 dhe 26 të këtij udhëzimi, në varësi të plotësisë së informacionit të paraqitur, siç përcaktohet në aneksin 5.

25.8 Për aplikimet për MÇA dypalëshe, sapo të jetë administrativisht e mundur, por jo më vonë se 60 ditë pas marrjes dhe pranimit të aplikimit zyrtar për MÇA-në, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të kontaktojë me partnerin/partnerët e konventës tatimore dhe do të pyesë nëse ai/ata dëshirojnë të procedojnë me aplikimin brenda kontekstit të konventës tatimore.

25.9 Nëse tatimpaguesi nuk ka pasur më parë një takim paradorëzimit me DPT-në, sipas pikës 24 të këtij udhëzimi, DPT-ja me nismën e saj, mund të kërkojë takimin me tatimpaguesin.

26. Vlerësimi (faza 3)

26.1 Pasi aplikimi për MÇA-në është pranuar dhe është në thelb i plotë, DPT-ja, brenda 60 ditëve pune, kryen një analizë kritike të aplikimit për MÇA-në përpara se të ndërmarrë punën fillestare për të vendosur përfundimin e çmimit të pavarur. Megjithatë, DPT-ja mund të ndërmarrë punën fillestare duke përfshirë punën në terren, kur kushtet e garantojnë.

26.2 Si pjesë e analizës, gjatë vlerësimit të MÇA-së, DPT-ja mund të ndërmarrë veprimtaritë e mëposhtme:

26.2.1 i kërkon tatimpaguesit të japë informacion shtesë, duke përfshirë informacionin lidhur me palët e lidhura;

26.2.2 kërkon takime me tatimpaguesin me qëllim që të diskutojnë çështje specifike;

26.2.3 ndërmerr kërkime të fushës dhe vizita në terren për të inspektuar veprimtaritë e tatimpaguesit;

26.2.4 interviston personelin e tatimpaguesit;

26.2.5 kërkon informacione të vlefshme nga partnerët e konventës tatimore nën shkëmbimin e informacionit, në pajtim me dispozitat përkatëse të një konvente të aplikueshme tatimore; dhe/ose

26.2.6 ushtron çdo kompetencë përkatëse sipas legjislacionit fiskal për vlerësimin e marrëveshjes.

26.3 Kur DPT-ja bën një vlerësim të ndryshëm nga ai që përmban aplikimi i tatimpaguesit, ajo do ta diskutojë vlerësimin e saj me tatimpaguesin. DPT-ja do të kërkojë që tatimpaguesi të shprehet mbi pozicionin e tij në lidhje me këtë vlerësim, me qëllimin për të arritur një marrëveshje të përbashkët me tatimpaguesin.

26.4 Gjatë vlerësimit të MÇA-së, tatimpaguesit i kërkohet, që:

26.4.1 të mundësojë personelin dhe mjediset e nevojshme respektivisht për intervistë dhe inspektim; dhe

26.4.2 Të marrë dhe japë informacione lidhur me palët e lidhura.

26.5 nëse aplikimi është dypalësh ose shumëpalësh nën kushtet e një Konvente tatimore, do të aplikohet procedura e mëposhtme:

26.5.1 tatimpaguesi duhet të këshillojë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për informacionin/dokumentacionin e kërkuar nga partnerët e konventës tatimore në lidhje me aplikimin dhe duhet të sigurohet që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është pajisur me kopjet e çdo informacioni/dokumentacioni të paraqitur te partneri/ët e konventës tatimore, qoftë nga ai vetë apo një palë e lidhur.

27. Negocimi (faza 4)

MÇA-ja e njëanshme

27.1 Sapo DPT-ja përfundon analizat e saj, ajo njofton me shkrim brenda 10 ditëve tatimpaguesin me anë të një letre, e cila paraqet pozicionin e DPT-së, dhe jep shpjegimin në masën që pozicioni i saj

është i ndryshëm nga propozimi i tatimpaguesit në aplikim.

27.2 Nëse ka ndryshime ndërmjet pozicionit të tatimpaguesit dhe pozicionit të DPT-së lidhur me MÇA-në, tatimpaguesi duhet t'i paraqesë me shkrim DPT-së arsyetimin e tij lidhur me metodën e transferimit të çmimit apo kushteve të tjera të MÇA-së së propozuar, para fillimit të takimeve individuale.

27.3 Pas marrjes së përgjigjes nga tatimpaguesi, sikurse parashikohet në pikën 27.2, nëse ka ende ndryshime ndërmjet pozicioneve, DPT-ja do t'i mundësojë tatimpaguesit një takim brenda 15 ditëve për të diskutuar çështjet, me synimin për të arritur një marrëveshje.

MÇA dypalëshe ose shumëpalëshe

27.4 Në rastin e një MÇA-je dypalëshe ose shumëpalëshe, DPT-ja do të shkëmbejë letra për qëndrimin e saj me autoritetin/et kompetent/e të huaj/a palë e MÇA-së, dhe do të ndjekë procedurat e mëposhtme:

27.4.1 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund të bëjë takime individuale me palën e autoritetit kompetent të huaj në MÇA;

27.4.2 Tatimpaguesi nuk e ka të drejtën të shohë qëndrimin e shprehur ose materiale të tjera të shkëmbyera me shkrim ndërmjet autoriteteve kompetente si palë në procesin e negocimit. Dokumente të tilla jepen sipas procedurës së marrëveshjes reciproke të konventës përkatëse tatimore, e cila kufizon përdorimin dhe zbulimin e saj;

27.4.3 Tatimpaguesi nuk ka të drejtën të jetë i pranishëm në negocimin e Autoritetit Kompetent, përveç rasteve kur aprovimi për paraqitje në mbledhjet e Autoriteteve Kompetente është marrë nga të gjithë Autoritetet Kompetente të interesuara; dhe

27.4.4 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të mbajë tatimpaguesin të përditësuar mbi statusin e negociatave dypalëshe dhe do t'i komunikojë çdo afat kohor të rënë dakord me autoritetin tjetër kompetent, sipas nevojës;

27.4.5 Në rastin e marrëveshjeve dypalëshe, autoritetet kompentente të shteteve kontraktore mund të bien dakord me një marrëveshje të përbashkët me shkrim e cila përcakton metodën e pranuar të transferimit të çmimit, aplikimin e saj dhe supozimet kritike. Marrëveshja e përbashkët mund të jetë në çdo formë shkresore, e shkëmbyer midis Autoriteteve Kompetente të dy palëve;

27.4.6 Tatimpaguesi mund të pranojë ose të refuzojë marrëveshjen e përbashkët për MÇA-në. Tatimpaguesi duhet të njoftojë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me shkrim, nëse marrëveshja e përbashkët është pranuar apo jo, brenda 30 ditëve kalendarike;

27.4.7 Kur marrëveshja e përbashkët është pranuar, DPT-ja harton një MÇA bazuar në marrëveshjen e përbashkët dhe ia paraqet këtë tatimpaguesit për nënshkrim. Tatimpaguesit i kërkohet ta nënshkruajë MÇA-në përfundimtare dhe t'ia kthejë atë DPT-së.

27.5 Në rastet kur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk është në gjendje të arrijë marrëveshjen me partnerin (ose partnerët) e konventës tatimore brenda 90 ditëve, atëherë një MÇA e njëanshme mund të lidhet me tatimpaguesin. Në këto raste Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton me shkrim tatimpaguesin.

27.6 Në rastin e të gjitha MÇA-ve, përmbajtja e marrëveshjes së arritur (transaksionet e mbuluara, personat juridikë të mbuluar, periudha, metoda e aplikuar e transferimit të çmimit, rezultatet dhe konsideratat përkatëse) e rënë dakord në MÇA, mund të ndryshojë nga ajo e propozuar në aplikimin e tatimpaguesit.

28. Hartimi dhe marrëveshja (faza 5)

28.1 Në përputhje me sa është rënë dakord në negociata, DPT-ja do të përgatisë versionin përfundimtar të MÇA-së dhe do t'ia dërgojë atë tatimpaguesit, për ta nënshkruar e zbatuar. Një kopje e nënshkruar i kthehet DPT-së brenda 10 ditëve.

28.2 Forma dhe përmbajtja e MÇA-së së përfunduar.

Një MÇA e përfunduar duhet të përmbajë së paku informacionin e mëposhtëm:

28.2.1 Emrin dhe adresat e palëve në MÇA;

28.2.2 Transaksionet e kontrolluara të mbuluara nga MÇA-ja;

28.2.3 Periudhën dhe vitet fiskale të mbuluara nga MÇA-ja;

28.2.4 Metodologjinë e transferimit të çmimit të rënë dakord dhe zbatimin e saj ndaj transaksioneve të kontrolluara të mbuluara;

28.2.5 Nëse është e aplikueshme, vargun e çmimeve të palëve të pavarura të pranuar nën MÇA;

28.2.6 Një përcaktim të kushteve përkatëse të cilat formojnë bazën e llogaritjes së metodologjisë së transferimit të çmimit;

28.2.7 Standardet e llogaritjeve të bëra mbi të cilat bazohet deklarimi financiar;

28.2.8 Gjykimet kritike mbi të cilat është bazuar metodologjia e transferimit të çmimit;

28.2.9 Procedurat që duhen ndjekur nëse është e nevojshme për të bërë rregullime kompensuese; dhe

28.2.10 Detyrimet që rrjedhin për tatimpaguesin si rezultat i MÇA-së (p.sh. detyrimi i tatimpaguesit për të dorëzuar Raportet Vjetore të Pajtueshmërisë dhe regjistrimet e tatimpaguesit që plotësojnë kërkesat).

Supozimet kritike

28.3 Një MÇA do të përcaktojë në avancë supozimet kritike, duke përfshirë edhe ato supozime të cilat nuk janë në kontrollin e tatimpaguesit ose të DPT-së. Këto supozime përfshijnë çdo fakt mbi tatimpaguesin, një filial, një palë të tretë, një industri apo kushte ekonomike të përgjithshme.

Supozimi është kritik nëse shkelja e tij mund të ndikojë ndjeshëm në zbatimin e kushteve thelbësore të MÇA-së ose në bazat mbi të cilat ajo është rënë dakord. Supozimet kritike nga natyra e tyre janë thelbësore për MÇA-në dhe duhen hartuar me kujdes për të siguruar që MÇA-ja reflekton parimin e tregut dhe mbron sigurinë e MÇA-së.

28.4 DPT-ja do të vlerësojë nëse palët e pavarura kanë parashikuar ngjarje ose rrethana në kohën kur MÇA-ja ka hyrë në fuqi dhe nëse metodologjia e transferimit të çmimit e pranuar është marrë ose jo sa duhet në konsideratë. DPT-ja do të përdorë testin e palëve të pavarura për të përcaktuar nëse ato do të kishin rinegociuar një marrëveshje të tillë për arsye të ndryshimit në supozimet kritike.

28.5 Tatimpaguesi duhet të njoftojë me shkresë zyrtare DPT-në se një supozim kritik është shkelur, dhe të dorëzojë dokumentacionin mbështetës me një kurs veprimi të propozuar (p.sh. rishikimin e MÇA-së), brenda 30 ditëve.

28.6 DPT-ja do vlerësojë nëse palët e pavarura kanë parashikuar ngjarje ose rrethana në kohën kur MÇA-ja ka hyrë në fuqi dhe nëse metodologjia e transferimit të çmimit e pranuar është marrë sa duhet në konsideratë. DPT-ja do të përdorë testin e palëve të pavarura për të përcaktuar nëse palët e pavarura do të kishin rinegociuar një marrëveshje të tillë për arsye të ndryshimit në supozimet kritike.

Nëse MÇA-ja rishikohet, data efektive e rishikimit të MÇA-së do të shprehet në MÇA-në e rishikuar. MÇA-ja e rishikuar duhet të shënojë gjithashtu datën mbi të cilën MÇA-ja origjinale nuk është më efektive.

Nëse një MÇA e rishikuar nuk mund të negociohet, ajo do të anulohet ose pezullohet. MÇA-ja do të anulohet ose pezullohet nga fillimi i vitit në të cilin ndodhi ngjarja që solli ndryshimin e rrethanave. Në përgjithësi, një MÇA ka si qëllim të jetë e zbatueshme për të gjithë vitin ose të jetë e pazbatueshme për të gjithë atë vit.

29. **Raporti Vjetor i Pajtueshmërisë (faza 6)**

29.1 DPT-ja mund të auditojë një tatimpagues që është palë në një MÇA, si pjesë e auditit të rregullt të tij tatimor, megjithatë, në lidhje me transaksionin e mbuluar në MÇA, qëllimi i auditimit do të kufizohet në plotësimin e dispozitave të MÇA-së.

29.2 Për çdo periudhë tatimore të mbuluar nga MÇA, tatimpaguesi është i detyruar të dorëzojë në DPT Raportin Vjetor të Pajtueshmërisë së MÇA-së së përfunduar. Forma dhe përmbajtja e Raportit Vjetor të Pajtueshmërisë të MÇA-së specifikohet në aneksin 6 të këtij udhëzimi.

29.3 Data për dorëzimin e Raportit Vjetor të Pajtueshmërisë të MÇA-së, është data e detyrueshme për dorëzimin e "Deklaratës së tatimit mbi fitimin" dhe "Formularit të pagesës". Ajo mund të dorëzohet e printuar me bilancin dhe pasqyrat financiare ose në mënyrë elektronike, siç kërkohet nga DPT-ja.

29.4 Nëse tatimpaguesi nuk dorëzon Raportin Vjetor të Pajtueshmërisë, ose dorëzon një njoftim të pasaktë ose të paplotësuar të Raportit Vjetor të Pajtueshmërisë, kjo do të konsiderohet si papajtueshmëri me një nga dispozitat e MÇA, për qëllimin e pikës 31 të këtij udhëzimi.

30. E drejta e tërheqjes dhe refuzimit

30.1 Në rastin e Marrëveshjeve të Njëanshme të Çmimit në Avancë, tatimpaguesi ose DPT-ja, mundet që në çdo kohë gjatë procesit, të tërhiqen nga procesi nëse ata vërejnë qartë se do të jetë e pamundur të përfundojnë me sukses një MÇA. Tërheqja duhet të njoftohet me shkrim dhe arsyet e tërheqjes duhet të specifikohen qartë. Gjykohet që tërheqja të jetë rezultat i sjelljes në kundërshtim me aneksin 3.

30.2 Në rastin e tërheqjes nga ana e DPT-së, tatimpaguesi ka të drejtë të ankimojë me shkrim pranë drejtorit të përgjithshëm tërheqjen, brenda 30 ditëve. DPT-ja, pas marrjes me shkrim të ankimimit

mund ta rikonsiderojë tërheqjen e mëparshme dhe të riangazhohet në negocime.

30.3 Në rastin e MÇA-ve, dypalëshe apo shumëpalëshe, tatimpaguesi mund të komunikojë me shkrim në çdo kohë synimin e tij për të refuzuar pranimin e rezultatit të negociatave, dhe mos të hyjë në një MÇA. Megjithatë, kjo bëhet pavarësisht nëse Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve tërhiqet apo jo, nga negocimet me partnerin(ët) e konventës tatimore.

30.4 Në rastin kur është arritur një marrëveshje reciproke ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe partnerit/ëve të tij të konventës tatimore, tatimpaguesi mund të rrëzojë marrëveshjen me anën e refuzimit për të hyrë në MÇA. Në raste të tilla, tatimpaguesi humbet të drejtën e aplikimit për procedurën e marrëveshjes reciproke, në lidhje me transaksionet e kontrolluara të mbuluara nga kjo marrëveshje. Përveç kësaj, tatimpaguesi humbet gjithashtu të drejtën për çdo MÇA të njëanshme lidhur me transaksionet e kontrolluara në fjalë.

31. Mosplotësimi i kërkesave të marrëveshjes

31.1 Nëse janë shkelur një ose më shumë dispozita të MÇA-së, DPT-ja mundet që, në përputhje me pikat 32-34 të këtij udhëzimi, të ndryshojë, anulojë ose revokojë MÇA.

31.2 Pikat 32-34 të këtij udhëzimi janë të zbatueshme në të gjitha rastet dhe nuk mund të parandalohen nga dispozitat e një Marrëveshjeje specifike të Çmimit në Avancë.

32. Rishikimi

32.1 DPT-ja, në konsultim me tatimpaguesin, mundet të rishikojë dispozitat e Marrëveshjes së Njëanshme të Çmimit në Avancë, nëse plotësohet njëra nga kushtet e mëposhtme:

32.1.1 ka një ndryshim material në zbatimin e Legjislacionit Tatimor Shqiptar; ose

32.1.2 të dyja palët, DPT-ja dhe tatimpaguesi, kanë shprehur me shkrim dëshirën për të rishikuar dispozitat që vijnë si pasojë e ndryshimeve në ekonomi ose konsiderata të tjera përkatëse.

32.2 Data efektive e çdo rishikimi duhet të miratohet ndërmjet DPT-së dhe tatimpaguesit.

32.3 Në rastin e një rishikimi të marrëveshjes reciproke, MÇA-ja që zbaton atë marrëveshje reciproke, për aq sa kërkohet, do të rishikohet në përputhje me rrethanat.

33. Anulimi

33.1 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund të anulojë një Marrëveshje të Njëanshme të Çmimit në Avancë, kur plotësohet njëra nga kushtet e mëposhtme:

33.1.1 ka pasur një keqprezantim, gabim ose mosveprim që nuk është pasojë e neglizhencës apo pakujdesisë, ose mosveprim të qëllimshëm të tatimpaguesit kur ka plotësuar aplikimin, gjatë negocimeve të marrëveshjes, ose në përputhje me raportimin dhe përmbushjen e kërkesave;

33.1.2 tatimpaguesi nuk përmbush një ose më shumë nga dispozitat e MÇA-së;

33.1.3 ka shkelje materiale të një apo më shumë nga supozimet kritike; dhe/ose

33.1.4 kur pika 32 është e aplikueshme, por asnjë marrëveshje nuk është e mundur të arrihet ndërmjet DPT-së dhe tatimpaguesit, brenda një periudhë prej 60 ditësh.

33.2 MÇA do të pushojë së qeni e zbatueshme nga data e anulimit.

33.3 Data e anulimit do të përcaktohet sipas datës së ngjarjes që solli anulimin. Nëse një datë e tillë nuk mund të përcaktohet, p.sh. kur ndodh një ndryshim material në një nga supozimet kritike, anulimi do të jetë efektiv nga viti fiskal në të cilin ka ndodhur ngjarja. Efekti i anulimit është i tillë që DPT-ja dhe tatimpaguesi nuk do të jenë më të detyruar nga marrëveshja, që nga data e anulimit.

33.4 DPT-ja mund të heqë dorë nga anulimi nëse tatimpaguesi mund të tregojë se ka shkaqe të arsyeshme, dhe palët bien dakord për një rishikim të marrëveshjes në përputhje me pikën 32 të udhëzimit.

33.5 Në rastin e MÇA- së dypalëshe ose shumëpalëshe, marrëveshja anulohet vetëm në përputhje me dispozitat e marrëveshjes arritur mes autoriteteve kompetente.

34. Revokimi

34.1 DPT-ja mund të revokojë një Marrëveshjë të Njëanshme të Çmimit në Avancë kur ka pasur një shtrembërim, gabim ose mosveprim që është pasojë e neglizhencës apo pakujdesisë, ose mospagim të qëllimshëm të tatimpaguesit kur ka plotësuar aplikimin, gjatë negocimeve të marrëveshjes, ose në përputhje me raportimin dhe kërkesat.

34.2 Efekti i revokimit sjell pasoja të atilla sikur marrëveshja të mos ketë ekzistuar asnjëherë.

34.3 Në rastin e një MÇA-je dypalëshe ose shumëpalëshe, marrëveshja revokohet vetëm në

përputhje me dispozitat e marrëveshjes së arritur ndërmjet autoriteteve kompetente.

35. Rinovimi

35.1 Dorëzimi i një aplikimi për të kërkuar rinovimin e një MÇA-je, duhet të ndjekë të njëjtat procedura të parashikuara në pikat 23–29 të këtij udhëzimi.

35.2 Ndërsa në praktikë termat dhe kushtet e Marrëveshjes së mëparshme të Çmimit në Avancë do të jenë influencuese kundrejt negocimit të rinovimit, termat dhe kushtet e pranuara në Marrëveshjen e mëparshme të Çmimit në Avancë janë pa paragjykim për rinovimin.

36. Konfidencialiteti

36.1 Në përputhje me nenin 25, "Konfidencialiteti", të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, informacioni i paraqitur nga tatimpaguesi gjatë takimit paradorëzimit, në aplikim, gjatë negocimit dhe në marrëveshjen përfundimtare, është konfidencial dhe duhet të përfaqësojë një sekret tatimor. Megjithatë, DPT-ja rezervon të drejtën e dhënies së informacionit statistikor publik mbi baza anonime, siç kërkohet për plotësimin e "Raportit Vjetor të Programit të MÇA-së" (shiko pikën 37).

36.2 Në lidhje me MÇA-në dypalëshe ose shumëpalëshe, dispozita e shkëmbimit të informacionit të konventës përkatëse tatimore, aplikohet në shkëmbimin e informacionit për qëllimet e dispozitave të MÇA-së. Kështu ruhet konfidencialiteti i informacionit të shkëmbyer për qëllimet e MÇA-së.

37. **Raporti Vjetor i Programit të MÇA-së**

37.1 DPT-ja, është e detyruar të përgatisë dhe të japë një Raport Vjetor mbi Programin e Marrëveshjes së Çmimit në Avancë.

37.2 Raporti Vjetor duhet të specifikojë për vitin zbatues:

- numrin dhe llojin e aplikimeve të pranuara të MÇA-së, të evidentuar sipas llojit të marrëveshjes dhe rinovimeve;
- numrin e aplikimeve të pranuara dhe të refuzuara, të evidentuara sipas llojit të marrëveshjes dhe rinovimit;
- tarifat totale të aplikimeve të arkëtuara dhe të rimbursuara;
- numrin e MÇA-ve të hyra në fuqi dhe numrin e MÇA-ve në pritje (nën negocim), të evidentuara sipas llojit të marrëveshjeve dhe rinovimeve;
- periudhën mesatare kohore nga pranimi i aplikimit deri tek arritja e marrëveshjes, të evidentuara sipas llojit të marrëveshjes;
- numrin e MÇA-ve të ripara, revokuara apo anuluara, të evidentuara sipas llojit të marrëveshjes dhe rinovimeve;
- numrin e MÇA-ve të hyra në fuqi, apo të rinovuara, sipas klasifikimit të industrisë së tatimpaguesit;
- numrin e MÇA-ve të hyra në fuqi, ose të rinovuara, sipas llojit të transaksionit(eve) të mbuluar(a);
- numrin e MÇA-ve të hyra në fuqi, ose të rinovuara, sipas metodës së pranuar të transferimit të çmimit;
- numrin e MÇA-ve të hyra në fuqi gjatë vitit, me secilin partner të konventës tatimore.

38. Shfuqizime

Ky udhëzim shfuqizon udhëzimin nr. 16 datë, 18.6.2014, "Për transferimin e çmimit" dhe udhëzimin nr. 9, datë 27.2.2015 "Mbi marrëveshjet e çmimit në avancë"

39. Hyrja në fuqi

Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi me fillimin e efekteve të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Ervin Mete

ANEKSI 1
JURIDIKSIONE TË SPECIFIKUARA

Lista e mëposhtme përfshin vendet sipas përcaktimit të dhënë në pikën 3.6 të këtij udhëzimi.

Nr.	Emri i juridiksionit
1	Andora
2	Antigua & Bermuda
3	Antigua
4	Aruba
5	Bahamas
6	Bahrain
7	Barbados
8	Belize
9	Bermuda
10	Brunei
11	Costa Rica
12	Dominica
13	Fiji
14	Gibraltar
15	Grenada
16	Guadalupe
17	Guam
18	Guatemala
19	Guernsey
20	Guyana
21	Haiti
22	Hong Kong
23	Ishujt British Virgin
24	Ishujt Cook
25	Ishujt Falkland
26	Ishujt Normand
27	Ishujt Solomon
28	Ishujt Turks dhe Caicos
29	Ishulli Christmas
30	Ishulli Mariana
31	Ishulli Marshall
32	Ishulli US Virgin
33	Isle of Man
34	Jamaica
35	Jersey
36	Liberia
37	Liechtenstein
38	Macao
39	Madeira
40	Maldives
41	Martinique
42	Mauritius
43	Micronesia
44	Monaco
45	Montserrat
46	Nauru
47	Netherland Antilles
48	Niue
49	Oman
50	Palau
51	Panama
52	Philippine
53	Republika Domenicane
54	Samoa
55	San Marino
56	Seychelles
57	St. Kitts dhe Nevis
58	St. Lucia
59	St. Vincent dhe Grenadines
60	Surinam
61	Tanzania
62	Tonga
63	Trinidad Tobacco
64	Tuvalu
65	Vanuatu

ANEKSI 2

NJOFTIMI I TRANSAKSIONEVE VJETORE TË KONTROLLUARA
(ANNUAL CONTROLLED TRANSACTIONS NOTICE)

Periudha fiskale për të cilën plotësohet ky formular fillon më 01/01/201_ deri 31/12/201_
(The fiscal period on which is filled this form begins from 01/01/201_ to 31/12/201_)

Shënim. Është subjekt i plotësimit të këtij formulari vetëm tatimpaguesi i cili gjatë periudhës raportuese ka transaksione te kontrolluara totale (duke përfshirë tepricat e huave) që kalojnë 50.000.000 lekë. Në përcaktimin e transaksioneve të kontrolluara totale të një tatimpaguesi për periudhën raportuese, duhet të përdoren vlerat absolute. Kjo do të thotë se të ardhurat dhe shpenzimet duhet të pasqyrohen veçmas, pra ato nuk mund të kompensohen (netohen).

Note: It is subject of filing this form only the taxpayer which during the reporting period has aggregate controlled transactions (including loan balances) exceeding 50.000.000 ALL. In determining a taxpayer's aggregate controlled transactions for a reporting period, absolute values must be used. That is income and expenses must be evidenced separately, i.e. can not be offset.

Pjesa e I-rë. Informacion mbi tatimpaguesin raportues
(Part I. Information on reporting taxpayer)

1. Emri i tatimpaguesit
   Name of Taxpayer |___|___|___|

Pjesa e II-të. Informacion mbi transaksionet e kontrolluara
Part II. Information on controlled transactions

8. Ju lutem listoni transaksionet e kontrolluara të kryera gjatë vitit që sjellin të ardhura të tatueshme dhe shpenzime të zbritshme siç kërkohet në tabelën e mëposhtme:
(Transaksionet me të njëjtin kod transaksioni të kryera me të njëjtin person pasqyrohen në shumë totale por nuk kompensohen

Please list controlled transactions conducted during the year which give rise to taxable (assessable) income and tax deductible expenses as required in below table:
(Transactions of the same transaction code with the same party are reflected in aggregate, but not offset).

NR	Të dhëna identifikuese të palëve të tjera (Identification information on other parties)				Kodii transaksionit / Transaction Code	Transaksioni në lekë, Transaction in ALL		Metoda e transferimit* çmimit / Method of TP*	Doc. i përgatitur TC (TP. documentation prepared)	
	Emri (Name)	Palë të lidhura (Associated Parties)		Rezidenca tatimore (Tax Residence)		Zbritje të lejueshme (Allowable deductions)	Të ardhura të vlerësueshme (Assesable incomes)		Po (Yes)	Jo (No)
		Po (Ye)	Jo (No)							
1										
2										
3										
4										
5										
6										
7										
8										
.....										
	Totali/Total				xxxxx			xxxxx	xx	xx

* Në kolonën "Metoda e transferimit të çmimit" evidentoni metodën e përdorur të transferimit të çmimit nëpërmjet shkurtimeve të përcaktuara në fund të këtij aneksi (CUP, RS, CP, TNMM, CPM dhe OM).
*In the columnn Method TP evidence the type of TP method used (CUP, RS, CP, TNMM, CPM and OM).

9. Gjendja e huave me palët e lidhura
Associated party loan balances

Ju lutem evidentoni gjendjen e huave të marra ose të dhëna nga/me palët e lidhura si dhe nga/me me persona në juridiksionet specifike.
Please disclose total balance of amounts borrowed or loaned by/with associated parties and by/with specified jurisdictions:
Shumat e marra hua (Amount Borrowed)

Të dhëna identifikuese të personit jorezident (emri) Identification information on non-resident associated parties (Name)	Rezidenca tatimore (Tax Residence)	Pa interes (Interest free)		Bilanci në fillim të periudhës raportuese në lekë Opening balance at beginning of reporting period in ALL	Bilanci në mbyllje të periudhës raportuese në lekë Closing balance at end of tax year in ALL
		Po (Yes)	Jo (No)		

Shumat e dhëna hua (Amounts loaned)

Të dhëna identifikuese të personit jorezident (emri) Identification information on non-resident associated parties (Name)	Rezidenca tatimore (Tax Residence)	Pa interes (Interest free)		Bilanci në fillim të periudhës raportuese në lekë Opening balance at beginning of reporting period in ALL	Bilanci në mbyllje të periudhës raportuese në lekë Closing balance at end of tax year in ALL
		Po (Yes)	Jo (No)		

10. Ju lutem përshkruani ndryshime (nëse ka) në strukturën ligjore të grupit apo ndryshime të tjera në funksionet e ushtruara, asetet e përdorura dhe rreziqet e marra.
Please describe changes (if any) to the legal structures of the group or other changes regarding functions exercised, assets used or risks assumed.

11. Ju lutem, listoni transaksionet e kontrolluara që lidhen me blerjen ose tjetërsimin e aktiveve kapitale (të trupëzuara ose të patrupëzuara) / Please, list the controlled transactions related to acquisition or alienation of capital assets (tangible or intangible).

Transaksionet kapitale / Capital Transactions

Të dhëna identifikuese të personit jo rezident (emri) ***identification information on non-resident associated parties (name)***	**Të lidhura** ***(associated)***		**Rezidenca tatimore** ***(tax residence)***	**Të ardhura nga tjetërsimi** ***(proceeds from alienation)***	**Çmimi i blerjes** ***(purchase price)***
	po ***(yes)***	**jo** ***(no)***			

12. A keni ofruar mallra apo shërbime tek palët e lidhura pa pagesë ose pa shpërblim?
(Did you provide any goods or services to associated parties for non monetary or no consideration? ☐ Po (Yes) ☐ Jo (No)

13. A keni marrë mallra apo shërbime nga palët e lidhura pa pagesë ose pa shpërblim?
(Did you receive any goods or services to associated parties for non monetary or no consideration) ? ☐ Po (Yes) ☐ Jo (No)

Pjesa e III. Të përgjithshme
(Part III). General

14. **Kodet e transaksioneve** / Transactions codes

Lloji i transaksionit/ Type of transaction	Kodi i transaksionit/ Transaction Code
Aktive materiale / Tangible goods	A
Lëndë të para / Raw materials	A1
Mallra të përfunduara / Finished goods	A2
Pagesa të tjera për aktive materiale / Other payments for tangible goods	A3
Aktive jomateriale / Intangible	B
Honorare/ Royalties	B1
Qira (të ndryshme nga honoraret) / Rent (Other than royalty)	B2
Pagesa të tjera për aktive jomateriale / Other payments for intangible	B3
Shërbimet / Services	C
Shërbime menaxhimi / Management	C1
Shërbime administrimi / Administration	C2
Shërbime teknike / Technical	C3
Shërbime marketingu/ Marketing	C4
Kërkim dhe zhvillim/ Research and development	C5
Trajnime / Trainings	C6
Komisione / Commissions	C7
Shërbime të tjera / Other services	C8
Shërbime financiare dhe sigurimi / Financial and insurance	D
Interesa / Interest	D1
Zbritjet / Discounts	D2
Siguracione / Insurance	D3
Pagesa garancie / Guarantee fees	D4
Të tjera shërbime financiare/ Other financial services	D5
Çdo e ardhur ose shpenzim tjetër / Any other income or expense	E
Alokim shpenzimesh / Recharge of expenses	E1

15. Shkurtime:
Abbreviations:

Metoda e çmimit të krahasueshëm të pakontrolluar (CUP) / Comparable Uncontrolled Price (CUP) Method
Metoda e Çmimit të Rishitjes (RP) / Resale Price (RP) Method

Metoda kosto plus (CP) / Cost Plus (CP) Method
Metoda e marzhit neto Transaksional (TNMM) / Transactional Net Margin Method (TNMM)
Metoda e ndarjes se fitimit (SPM) / Profit split method (SPM)
Metoda të tjera (OM) / Other Methods (OM)

16. Certifikim mbi saktësinë
Certification on the accuracy

Unë vërtetoj se informacioni i dhënë në këtë deklarim dhe në çdo dokumentacion që i bashkëngjitet atij është i njohur nga ana ime, është përgatitur në mirëbesim, bazuar në informacionin dhe evidencë më të mirë të disponuar.
I certify that the information given in this form and in any documents attached is prepared in good faith, based on the best information and evidence possessed.

Emri dhe mbiemri i administratorit/drejtorit _____
Name and surname of

Administrator/DirectorNënshkrimi

Signature

ANEKSI 3 - Përmbledhja e pritshmërive reciproke

A1.1 Tatimpaguesit kërkojnë nga DPT:

(a) Të ndërmarrë një dialog të hapur dhe të vazhdueshëm me tatimpaguesin gjatë tërë procesit;
(b) Të punojë mbi fushën e marrëveshjes së çmimit në avancë dhe përqasjen e trajtimit për çdo çështje kolaterale kur është e nevojshme;
(c) Të kërkojë brenda transaksioneve të kontrolluara, metodologjinë e transferimit të çmimit dhe çmimit të pakontrolluar;
(d) Të ndërmarrë një shqyrtim për kolateralet e lëshuara, nëse ka, dhe të kordinojë zgjidhjen e tyre;
(e) Të angazhohet për zbatimin e kushteve të rëna dakord në MÇA, të cilat ndryshohen vetëm në raste të jashtëzakonshme;
(f) Të ofrojë në kohën e duhur informacione mbi ecurinë e aplikimit të tatimpaguesit për një MÇA;
(g) Të punojë me tatimpaguesin për të rënë dakord mbi informacionin/dokumentacionin e kërkuar në përpunimin e MÇA-së;
(h) Të hartojë bashkërisht me tatimpaguesin një plan pune në lidhje me MÇA-në që të përmbajë një afat kohor dhe një plan veprimi të strukturuar;
(i) Të punojë në mënyrë aktive me partnerin(ët) në zhvillimin e një MÇA-je dypalëshe/shumëpalëshe;
(j) Të ketë të drejtën e tërheqjes nga procesi i MÇA-së në çdo kohë përpara nënshkrimit të marrëveshjes përfundimtare tëçmimit në avancë.
(k) Të ruajë informacionin konfidencial në përputhje me dispozitat mbi fshehtësinë e nenit 25 "Konfidencialiteti" dhe dispozitës së shkëmbimit të informacionit në konventën (ose konventat) tatimore përkatëse; dhe
(l) të zbatojë procesin e MÇA-së në mënyrë të vazhdueshme dhe të shpejtojë procesin e MÇA-së në mënyrë që ta lidhë atë me procesin e partnerë(ve) të tjerë të konventës tatimore në MÇA-të dypalëshe/shumëpalëshe.

A1.2 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund të kërkojë nga tatimpaguesi:

(a) Të bashkëpunojë plotësisht me DPT gjatë të gjithë procesit;
(b) T'i sigurojë informacionin DPT në kohën e duhur;
(c) Të propozojë përqasjet të cilat janë në përputhje me ligjin "Për Tatimin mbi të Ardhurat" dhe kwtw Udhëzim;
(d) Të kërkojë një MÇA vetëm për transaksionet e kontrolluara të cilat janë aktuale dhe të vazhdueshme për nga natyra;
(e) Të paraqesë plotësisht dhe realisht të gjitha faktet materiale përkatëse në lidhje me transaksionet e kontrolluara dhe çështjet e tjera, nëse ka;
(f) Të punojë me DPT drejt arritjes sëmarrëveshjes në fushën e MÇA-së dhe trajtimin e çështjet e tjera, nëse ka;
(g) Të paraqesë çdo pozicion/qëndrim të kërkuar në mënyrë të arsyeshme në lidhje me transaksionet e kontrolluara dhe çështjet e tjera, nëse ka;

(h) Të ofrojëtë njëjtin informacion/dokumentacion tek të gjithë partnerët e konventave tatimore të cilat janë palët e propozuara në MÇA-në, dypalëshe/shumëpalëshe;
(i) Të sigurojë informacionin/dokumentacionin konform kompleksitetit të marrëveshjes dhe nivelin e rrezikut; dhe
(j) të ketë të drejtën për t'u tërhequr nga procesi i MÇA-së në çdo kohë para nënshkrimit të marrëveshjes përfundimtare MÇA-së.

ANEKSI 4- Pyetësori para-dorëzimi

Për të kërkuar një takim para-dorëzimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Ju lutemi plotësoni formularin e mëposhtëm dhe e dërgoni atë me shkresë zyrtare në adresën: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, rruga "Gjin Bue Shpata", Tiranë.

Për më shumë informacion mbi dërgimin e para-dorëzimit, lutemi shihni pikën 24 të këtij Udhëzimi.

Informacion i Përgjithshëm

1. Data e sotme:_____
2. Emri i Tatimpaguesit Shqiptar (ose Anonim):
3. Numri i Regjistrimit të Tatimpaguesit (përveçse kur është Anonim):
4. Emri i Përfaqësuesit të Tatimpaguesit dhe informacioni i Kontaktit:
5. Afatet e kërkuara të MÇA-së (vitet fiskale 20_____/____deri 20/____/____):
6. Lloji i MÇA së kërkuar: ☐ Njëanshme ☐ Dypalëshe ☐ Shumëpalëshe
7. Vendi(et) kryesor/e të huaja të përfshira në transaksionin(et) e mbuluara nga MÇA:
8. MÇA Fillestare ☐ MÇA e Rinovuar ☐

Transaksionet e mbuluara të propozuara

9. Përshkrimi i Transaksionit(eve) të mbuluar;
10. Shuma e Transaksionit të mbuluar (përcakto llojin e monedhës);
11. Përshkrim i shkurtër i Industrisë/Biznesit;
12. Metoda e propozuar e transferimit të çmimit;
13. Treguesi i Propozuar i Nivelit të Fitimit dhe gama e tregut (ose Pika);
14. Pala e Testuar e Propozuar.

Kërkesa e mbledhjes së para-dorëzimit

15. Data e propozuar /Koha për takimin e para-dorëzimit të dosjes

ANEKSI 5 - Përmbajtjet e aplikimit të kërkuar të MÇA: Plotësimi i informacionit

Lista e përmbajtjes së aplikimit të dhënë më poshtë nuk ka si synim të jetë shterues, por më shumë është një listë orientuese në lidhje me informacionin e kërkuar për pranimin e aplikimit nga DPT-ja në përputhje me pikën 25.1 të këtij Udhëzimi. Informacionet e mëtejshme mundtë kërkohen si pjesë e procesit të vlerësimit.

Saktësia e deklaratës

1. Tatimpaguesi duhet të përfshijë në çdo kërkesë përMÇA-nëedhe dorëzimin suplementartë një deklarate në formën e mëposhtme:

Nën gjobat për dëshmi të rreme:Unë deklaroj se kam shqyrtuar këtë kërkesë të MÇA-së. [dorëzimin plotësues] lidhur me këtë kërkesë MÇA-je, duke përfshirë dokumente shoqëruese dhe me vetëdije dhe besimin e plotë, kërkesa për MÇA-në, [dorëzimi plotësues] përmban të gjitha faktet përkatëse lidhur me [kërkesën e MÇA-së], [dorëzimin plotësues] dhe këto fakte janë të vërteta, të sakta dhe të plota.

Deklarata duhet të nënshkruhet nga personi apo personat në emër të të cilëve është bërë kërkesa dhe jo nga përfaqësuesi i tatimpaguesit. Personi që nënshkruan në emër të një tatimpaguesi korporate duhet të jetë një zyrtar i autorizuar i tatimpaguesit, i cili ka njohuri personale të fakteve.

Përfaqësuesi i tatimpaguesit

2. Emri dhe informacioni i kontaktit për përfaqësuesin e tatimpaguesit për MÇA-në;

Ndëmarrjet e lidhura të përfshira në MÇA

3. Një deklaratë e emrave dhe adresave të të gjitha shoqërive apo palëve të MÇA-së;
4. Detajet e grupit të shoqërisë në të cilën shoqëria është anëtare, duke përfshirë detajet e strukturës së pronësisë (p.sh. një skemë të aksioneve/kuotave të pronësisë);
5. Detajet e bizneseve kryesore dhe të vendeve ku këto biznese veprojnë;
6. Konfirmimi nëse propozimi i MÇA-së është e njëanshme, dypalëshe apo shumëpalëshedhe arsyet e perzgjedhjes;
7. Rezidenca tatimore e aplikantit, ndërmarrjeve të lidhura apo palëve që do të mbulohennga MÇA-ja e propozuar dhe juridiksionetose ndërmjet të cilave ato drejtojnë biznesin.

Afatet e MÇA-së

8. Vitet e propozuara për t'u mbuluar nga MÇA-ja.

Transaksionet e kontrolluara të mbuluara nga MÇA-ja

9. Një përshkrim i madhësisë, natyrës ose karakterizimit dhe vlera e transaksioneve të kontrolluara, të mbuluara nga MÇA-ja;
10. Një informacion i përgjithshëm mbi çdo transaksion tjetër të kontrolluar që nuk ka synim të mbulohet nga MÇA-ja;
11. Përshkrimet e marrëveshjeve kyçe ndërmjet shoqërive të lidhura;
12. Detajet e çfarëdo marrëveshje ose praktika të rëndësishme të transferimit të çmimit.

Analizat funksionale

13. Një përshkrim i biznesit të ndërmarrjes;
14. Hollësitë e funksioneve të rëndësishme ekonomike që kryhen nga secila palë e transaksioneve të kontrolluara të mbuluara nga MÇA-ja, asetet e përdorura në këtotransaksione dhe rrezikun e supozuar, duke u fokusuar në faktorët kyç për realizimin e këtyre transakioneve të kontrolluara.

Analizat e industrisë

15. Një përshkrim të industrisë dhe të tregut në të cilën vepron shoqëria;
16. Një shpjegim i pozicionit të shoqërisë në industri, duke përfshirë një listë të konkurrentëve kryesorë.

Përzgjedhja dhe aplikimi i metodologjisë së transferimit të çmimit

17. Një përshkrim të metodës së propozuar të transferimit të çmimit dhe arsyet se përse ajo metodë është më e përshtatshme;
18. Një shpjegim të metodës së transferimit të çmimit, e cila përdoret aktualisht për të testuar apo vendosur transferimin e çmimit të transaksioneve të kontrolluara, të mbuluara. Nëse është përdorur një metodë e panjohur, pohoni metodën e përdorur për vendosjen eçmimeve të tyre;
19. Një përshkrim të treguesve të nivelit më të përshtatshëm të fitimit dhe arsyet e përzgjedhjes se ketyre treguesve, kur është e nevojshme;
20. Të dhëna të mjaftueshme për të aplikuar metodologjinë e transferimit të çmimit dhe për të demostruar se rezultati i arritur është brenda parimit të tregu;
21. Burimi i propozuar i të dhënave të krahasueshme dhe karakteristikat kyçe ose kriteret që duhet të plotësohen nga çdo transaksion i pakontrolluar në mënyrë që të konsiderohet potencialisht i krahasueshëm;
22. Një përshkrim të krahasueshmërive të propozuara dhe një analizë e faktorëve kyç të krahasueshmërisë ndërmjet palës së krahasueshme dhe të testuar;
23. Detaje dhe llogaritje të çdo rregullimi të propozuara të rezultateve të krahasueshme;.
24. Rezultati i propozuar i tregut apodiapazoni që rezulton nga aplikimi i metodologjisë së transferimit të çmimit.
25. Rezultatet e parashikuara nga zbatimi i metodologjisë së propozuar (duke përfshirë analizat e ndjeshmërisë) gjatë afatit të MÇA-së.
26. Procesi nëpërmjet të cilit çdo rregullim i nevojshëm i rezultateve aktuale të shoqërisë mund të bëhet gjatë MÇA-së (rregullime kompensuese)

Të tjera

Pozicioni financiar dhe tatimor i të gjitha shoqërive të lidhura të përfshira në MÇA-në për së paku 3 vitet e fundit, duke përfshirë: shitjet, koston e mallrave të shitur, shpenzimet operative, fitimin para tatimeve, asetet, detyrimet, numrin e punonjësve dhe çdo të dhënë tjetër.

Informacion mbi projeksionet/buxhetimet financiare gjatë periudhës së MÇA-së.

Një përshkrim të çdo ngjarje kritike të veprimtarisë së sipërmarrjes së biznesit dhe aftësia e tij për të arritur rezultatet e parashikuara sipas MÇA-së së propozuar (d.m.th. supozime kritike).

Kërkesa shtesë për marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe të çmimit në avancë

Marrëveshja dhe deklarata

Unë bie dakord që të gjitha dokumentet dhe informacionet e dorëzuara në DPT për qëllim aplikimin të MÇA, mund t'i jepen autoritetit/ve kompetente të partnerëve të konventës tatimore përkatëse për procedimin e MÇA-së. Gjithashtu unë marr përsipër dërgimin e dokumenteve dhe informacioneve të njëjta autoritetit kompetent të partnerit/ve të konventës tatimore sipas kërkesave të tyre. Deklaroj se kam shqyrtuar aplikimin, përfshirë dokumentet shoqëruese, dhe me dijeninë time të plotë dhe me besimin se, faktet e paraqitura për aplikimin tim janë të vërteta, të plota dhe të sakta.

Emri i shoqërisë shqiptare:_____

Nënshkrimi i Zyrtarit Kryesor:_____

Emri dhe Titulli i Zyrtarit Kryesor:_____

Informacioni i plotësimit të aplikimit

(1) Tarifa (shoqëruar me një letër identifikuese, e cila përmban justifikimin e shumës së tarifës së paguar) duhet të dërgohet në :_____
[Adresa postare_____]

(2) Përmbajtja e aplikimit dhe informacioni shtesë i MÇA-së duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme:_____
[Adresa e caktuar]

**Lutemi kini parasysh se mund të kërkohen kopje shtesë të aplikimit të MÇA-së nëse nevojiten*

ANEKSI 6: Raporti Vjetor i Pajtueshmërisë

Në përputhje me këtë Udhëzim të Marrëveshjeve të Çmimit në Avancë (MÇA) në Shqipëri, tatimpaguesi shqiptar do të dorëzojë Raportin Vjetore të Përputhshmërisësë mëposhtme si pjesë shtojcë me deklarimin vjetor të tatimit të të ardhurave.

Seksioni I: Informacioni përmbledhës i MÇA-së

1. Emri i Tatimpaguesit, Shqipëri:
2. Numri i Regjistrimit të Tatimpaguesit:
3. Emri i Përfaqësuesit të Tatimpaguesit dhe informacioni i kontaktit; kontaktet:
   _____;_____;_____
4. Afati i MÇA-së (vitet e tatueshme 20_/__/__/ deri 20__/_____):
5. Kjo përmbledhja e Raportit Vjetor është për Vitin tatimor që përfundon:
6. Lloji i MÇA-së: Njëanshme ☐ Dypalëshe ☐ Shumëpalëshe ☐
7. Vendi(et) kryesore të huaja të përfshira në transaksionin(et) e mbuluara të MÇA-së:
   MÇA Fillestare ☐ MÇA e Rinovuar ☐
8. A ka patur ndryshime ose amendime kjo MÇA? ☐ Po Nëse Po, Data: ☐ Jo
9. A ka respektuar tatimpaguesi shqiptar afatet dhe kushtet e gjithëMÇA? ☐ Po ☐ Jo
10. A ka shkaktuar tatimpaguesi shqiptar ndonjë supozim kritik të detajuar në MÇA?
    ☐ Jo ☐ Po (Nëse Po, bashkëngjisni deklaratën shtesë të shpjeguar)
11. A ka rregullime kompensuese të kërkuara sipas kushteve të MÇA-së?
    ☐ Jo☐Po (Nëse Po, bashkëngjisni deklaratën shtesë me shpjegimin e rregullimit kompensues dhe ku rregullimi kompensues reflektohet në kthimin e tatimit mbi të ardhurat).
12. A ka ndonjë dallim material mes veprimtarisë të biznesit të tatimpaguesit shqiptar (duke përfshirë funksionet, rreziqet e supozuara, tregjet, kushtet kontraktuale, kushtet ekonomike, pasurisë, shërbimeve dhe aseteve tëpërdorura) gjatë vitit aktual të MÇA-së nga veprimtaritë e biznesit të përshkruar në kërkesën e MÇA-së?
    ☐ Jo ☐ Po (Nëse Po, bashkëngjisni deklaratën shtesë të shpjeguar)
13. A ka ndryshime materiale në metodat financiare dhe kontabël të llogaritjes së tatimit ose parimeve kontabël të përdorura për vitin e MÇA-së në lidhje me transaksionet e mbuluara, të cilat ndryshojnë nga metodat financiare dhe kontabël të llogaritjes së tatimittë përdorur në kërkesën e MÇA?
    ☐ Jo ☐ Po (Nëse Po, bashkëngjisni deklaratën shtesë të shpjeguar)

Seksioni II: Metoda e transferimit të çmimit

14. Pala e testuar e MÇA: Tatimpaguesi Shqiptar ☐ I Huaj ☐ Të dyja ☐

15. Testimet e MÇA- në (kontrollo të gjitha që zbatohen):

Baza disa vjetore ☐ Baza vjetore ☐ Baza afatgjatë ☐

16. MÇA mundëson (shëno të gjitha që zbatohen):

Norma pikëtavan ☐ Vetëm dysheme ☐ Tjetër (lutem specifikoni): ☐

_____

17. MÇA përcakton rregullime (shëno të gjitha që zbatohen):

Kufirin më të afërt ☐ Mesatar ☐ Pikë tjetër (lutemi specifikoni) ☐

_____

Seksioni III: Informacion shtesë i pajtueshmërisë së MÇA-së

Lutemi jepni informacionin shtesë si më poshtë vijon, për të demostruar përputhshmërinë me MÇA-në e referuar më lart:

1. Një deklaratë të shkurtër e cila demostron se si shoqëria shqiptare ka synuar në mënyrë aktive transferimin e çmimit të pranuar si pjesë të MÇA-së.
2. Informacionin dhe përllogaritjet e nevojshme për të konstatuar përfundimin e MÇA-së për transaksionet e mbuluara ndërmjet tatimpaguesit shqiptar dhe palëve të lidhura. Kjo përfshin demostrimin e shkallës së pajtueshmërisë së afateve dhe kushteve të MÇA-së.
3. Zërat shtesë që mund të jenë të përshtatshëm në rrethana specifike të tatimpaguesit shqiptar që ka të bëjë me MÇA-në e referuar.

DPT do të rishikojë Raportin Vjetor të Pajtueshmërisë dhe nëse është e nevojshme, mund të kërkojë informacione të mëtejshme që janë të nevojshme në mënyrë të arsyeshme për të vërtetuar se tatimpaguesi shqiptar i referuar në këtë Raport Vjetor të MÇA-së e ka plotësuar në përputhje me afatet dhe kushtet e MÇA-së.

Nëse tatimpaguesi shqiptar nuk ofron Raportin Vjetor të Pajtueshmërisë ose furnizimin me informacion shtesë të kërkuar sipas pikës 33 të këtij Udhëzimi, DPT mund të anulojë MÇA- në.

NJOFTIM
Nr. 17186, datë 17.11.2023

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE

Marrëveshja e pjesshme e zgjeruar (EPA), për themelimin e regjistrit të dëmeve të shkaktuara nga agresioni i Federatës Ruse kundër Ukrainës, aderuar në të me ligjin nr. 71/2023, ka hyrë në fuqi, për Republikën e Shqipërisë, në datën 3 nëntor 2023.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Sokol Dedja

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 170
Datë: 2023/11/21 14:30:36
e8ca3afb-6b64-4dab-a443-17ccbbede63f

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 288 lekë